



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 52/2021 (JR)
Datë 09.09.2021

Vendim nr. 55 (JR)
Datë 11.11.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 11.11.2024, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Olldashi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 401, datë 16.06.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pikat 2, 3, 5 dhe 10 të Kushtetutës; nenet A, Ç, D, Dh, E dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 62, 63 e vijues dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, në prani të Vëzhgueses

Ndërkombëtare Marie Tuma, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla (në vijim “subjekti i rivlerësimit/subjekti/ankuesja”) për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 të ligjit nr. 84/2016.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dhe dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; dhe (v) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti kishte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja dërgoi një raport² të arsyetuar pranë Komisionit bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.
5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

¹Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

²Raporti nr. {***}, data e dorëzimit është 02.11.2017, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 30.03.2021, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

³Referuar raportit nr. {***}, datë 24.02.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Alketa Zifla” për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”, subjekti ka dorëzuar pranë KLP-së formularin e vetëdeklarimit me shkresën nr. {***}, datë 07.05.2020.

6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni me vendimin nr. 401, datë 16.06.2021, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në kriteret e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe në vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat është konkluduar se:

- Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: *Subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri financiare në shumën – 904.448 lekë në vitin 2017 për të përballuar me burime të ligjshme shpenzimet e arsimimit të djalit të saj në kuptim të pikës 3, nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016. Nga vlerësimi në tërësi i veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me përfitimin e pasurisë apartament prej 59 m² në Tiranë, Komisioni ka çmuar se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.*

- Për kriterin e kontrollit të figurës: *Subjekti, znj. Alketa Zifla, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

- Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Subjekti, znj. Alketa Zifla, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.*

Në përfundim, mbështetur në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në provat e administruara, si dhe në rekomandimin e relatorit të çështjes, Komisioni arriti në përfundimin se: *Subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, ka kryer një sërë veprimesh juridike fiktive/të simuluar, të cilat nuk përputhen me sjelljen etike që një magjistrat/prokuror pritet të ketë, duke cenuar për rrjedhojë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë; ka mungesë të burimeve të ligjshme për të përballuar shpenzimet në vitin 2017, duke rezultuar me pamjaftueshmëri në shumën (-) 904.448 lekë.*

III. Shkaqet e ankimit

9. Kundër vendimit të Komisionit nr. 401, datë 16.06.2021, në datën 19.08.2021 ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, duke ngritur shkaqe ankimi me natyrë procedurale dhe materiale dhe kundërshton konkluzionin e Komisionit në lidhje me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe pamjaftueshmërinë financiare të burimeve të ligjshme për përballimin e shpenzimeve në vitin 2017, duke pretenduar se konkluzionet e arritura nga Komisioni, bazuar

edhe në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

10. Subjekti i rivlerësimit e shoqëroi ankimin me disa akte shkresore, për të cilat kërkoi marrjen e tyre në cilësinë e provave të reja⁴. Bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), subjekti i rivlerësimit kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë: (i) *Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative për vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 401, datë 16.06.2021, në lidhje me subjektin e rivlerësimit, znj. Alketa Zifla.* (ii) *Ndryshimin e vendimit nr. 401, datë 16.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.* (iii) *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.* Në funksion të shqyrtimit të ankimit, ankuesja depozitoi në Kolegji në datën 31.10.2024, edhe parashtrime me shkrim të shoqëruara me disa akte shkresore për të cilat kërkoi marrjen e tyre si prova të reja në gjykim⁵.
11. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
Komisioni, në shqyrtimin e çështjes, ka kryer shkelje procedurale dhe të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të cilat konsistojnë në: (i) Komisioni ka mbajtur një qëndrim subjektiv, të ndryshëm me çështjet e ngjashme⁶ të gjykuara prej tij; (ii) vendimi është rezultat i vlerësimit të gabuar të fakteve të rezultuara e të vërtetuara gjatë procesit administrativ dhe është i pambështetur në prova dhe në ligj; (iii) Komisioni ka interpretuar dhe vlerësuar konstatimet përtej synimeve dhe qëllimeve të kuadrit ligjor e kushtetues dhe në përgjithësi jo në frymën dhe qëllimin e gjithë reformës në drejtësi; (iv) vendimi bie në kundërshtim me praktikën tashmë të konsoliduar të mbajtur nga Kolegji në çështjet analoge, si dhe ka cenuar parimet e përgjithshme të proporcionalitetit, kontradiktoritetit dhe ligjshmërisë; (v) Komisioni, në arsyetimin e vendimit, ka qenë i paqartë dhe ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit, duke trajtuar me rezervë rrethanat faktike, në shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së; (vi) Komisioni nuk ka vlerësuar me objektivitet provat e administruara, si dhe periudhën e largët të kryerjes së veprimeve.
12. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijojnë.

⁴ (i) *Kthim përgjigjeje nga Banka Kombëtare Tregtare nr. {***} prot., datë 10.08.2021;* (ii) *të dhëna të printuara nga e-mail-i në lidhje me procedurën e legalizimit dhe apostilimit të deklaratave tatimore vjetore mbi të ardhurat e P. dhe A. K., rezidentë tatimorë në Kanada;* (iii) *të dhëna në lidhje me të ardhurat e personit të lidhur E. Z.;* (iv) *të dhëna në lidhje me shpenzimet e udhëtimit në Budapest të personit të lidhur K. Z.;* (v) *të dhëna për shpenzimet e udhëtimit të punës të subjektit në Podgoricë;* (vi) *të dhëna të printuara nga e-mail-i në lidhje me pagesën e shpenzimeve të qëndrimit në Vjenë të subjektit.*

⁵ *Dokumentacion origjinal dhe i apostiluar mbi të ardhurat e shtetasve P. dhe A. K., datë 06.12.2021, gjithsej 21 fletë, 42 faqe.*

⁶ *Vendimi i Komisionit (JR) nr. 218, datë 10.12.2019.*

12.1. Konkluzioni i Komisionit në lidhje me veprimet juridike të konsideruara të simuluar/fiktive dhe çmimin e kontratës së shitjes, është i pambështetur në ligj e në prova dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 80, 81 dhe 87 të Kodit të Procedurave Administrative.

12.2. Konstatimet e Komisionit në lidhje me përdorimin e kredisë me kushte lehtësuese jashtë juridiksionit territorial të Bashkisë Fier, sipas paragrafit 41, pikat b/2 dhe b/3 të vendimit janë në interpretim të gabuar të faktit në raport me ligjin nr. 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar, i cili në asnjë dispozitë të tij nuk përmend që kredia e lehtësuar duhet të përdoret brenda juridiksionit të bashkisë në të cilën aplikuesi rezulton i pastrehë. Ankuesja pretendon se kredia është përdorur plotësisht brenda qëllimit të saj, që ishte sigurimi i një banese për familjen e saj të pastrehë. Po ashtu, subjekti pretendon se nuk është njohur më parë gjatë hetimit administrativ, si dhe nuk i është kaluar barrë prove me qëllim realizimin e së drejtës për mbrojtje dhe për të provuar të kundërtën në lidhje me përfundimin e Komisionit në paragrafin 41, pika b.11 e vendimit, sipas së cilës subjekti e kishte fituar pronësinë e apartamentit objekt kreditimi që në datën 09.03.2012 dhe çmimi sipas kontratës së shitblerjes, në shumën 11.210.000 lekë, ishte paguar plotësisht.

12.3. Konkluzioni i Komisionit në lidhje me përdorimin e interesave bankarë të përfitur nga prindërit e saj nga investimi i fondit të kredisë, për shlyerjen e kësteve të kredisë dhe mosdeklarimin në deklaratat e pasurisë të këtyre të ardhurave në kundërshtim me pikën 4, germa “F” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, nuk qëndron. Prindërit e subjektit janë lejuar për të jetuar në banesë pa asnjë kundërshtim dhe, nga ana e saj, nuk janë shkelur kushtet e kredisë. Ndihma e dhënë nga prindërit e saj konsiston në pagesën e disa prej kësteve të kredisë në formën e lehtësimit të ngarkesës së saj financiare për shkak të kredisë, qirasë që paguante, si dhe shpenzimeve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Kjo pagesë, sipas saj, shkon në shumën kumulative prej 665.000 lekësh, e cila është dubluar në tabelat financiare të analizës së kryer nga Komisioni edhe si shpenzim i vetë subjektit të rivlerësimit.

12.4. Konkluzioni i Komisionit lidhur me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, si rrjedhojë e kryerjes së veprimeve juridike të simuluar dhe ndryshimit të çmimit të apartamentit në kontratën e shitjes, është i pambështetur dhe i paarsyetuar pasi, sipas subjektit, as ndryshimi i çmimit dhe as lidhja e kontratës së kaparit nuk cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Termi “besim” është përdorur si term abstrakt nga Komisioni dhe nuk është arsyetuar dhe analizuar se cilat fakte, rrethana, ngjarje apo sjellje shërbejnë si indikatorë për matjen e nivelit të cenimit dhe se në cilat raste mund të konkludohet që ky besim është cenuar. Po ashtu, ankuesja pretendon se, në lidhje me konkluzionin e arritur nga Komisioni, nuk provohet asnjë komponent i rëndësishëm në identifikimin e mundësisë që sjellja e subjektit të rivlerësimit të ketë ndikuar në cenimin e besimit të publikut te drejtësia dhe te vetë integriteti i saj si prokurore, si në sjelljen e saj profesionale, ashtu edhe atë jashtëgjyqësore. Sipas saj, Komisioni nuk ka konkluduar drejt mbi faktet e provuara, duke arritur në një konkluzion të gabuar në vështrim të neneve 4, pika 2 dhe 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, ligjshmërisë, proporcionalitetit, objektivitetit dhe barazisë para ligjit. Arsyetimi i vendimit ka qenë tepër i përgjithshëm dhe kontradiktor, duke cenuar parimin

e procesit të rregullt ligjor në shumë drejtime pasi, në përmbajtjen e vendimit, nuk u është dhënë zgjidhje, shpjegim e argumentim ligjor dy shkaqeve që kanë shërbyer si motivacion për shkarkimin e saj, atij për cenimin e besimit të publikut te drejtësia dhe mungesës së burimeve financiare për përballimin e shpenzimeve në vitin 2017.

12.5. Konkluzioni i Komisionit në lidhje me vlerësimin e rrethanave të përfshirjes së subjektit të rivlerësimit në hetimin e procedimit penal ndaj disa zyrtarëve të lartë të Bashkisë Fier, është në kundërshtim me rrethanat e marrjes dhe përdorimit të kredisë dhe një konkluzion haptazi i pabazuar në ligj. Në aspektin procedural, subjekti pretendon se nuk është njohur më parë dhe nuk i është kaluar barra e provës në lidhje me konkluzionin e mësipërm. Subjekti pretendon po ashtu se nuk gjendet në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, pasi interesi i saj, në dukje, ka përfunduar para trajtimit të kallëzimit penal në ngarkim të funksionareve të Bashkisë Fier dhe konflikti në dukje i interesit nuk ka ndodhur dhe as ka pasur mundësi që të ndodhte pasi nuk rezulton asnjë interes i supozuar që të ketë lidhje me vendimmarrjen e saj në kushtet kur, në lidhje me çështjen në fjalë, ka një vendim pafajësie të formës së prerë. Sipas subjektit të rivlerësimit, në rastin e saj, nuk ekziston një situatë e konfliktit të interesit, e cila, në vështrim të dispozitave të ligjit të posaçëm që rregullon konfliktin e interesit, të merret si komponent në procesit e rivlerësimit.

12.6. Konkluzioni i Komisionit për pamjaftueshmërinë financiare në shumën (-) 904.448 lekë në vitin 2017, për përballimin e shpenzimeve të arsimimit të djalit të saj, i është njoftuar për herë të parë në arsyetimin e vendimit. Sipas subjektit, Komisioni ka bërë një interpretim të gabuar të provave e fakteve në lidhje me të ardhurat prej 2.000 eurosh të personit të lidhur, djalit, si të ardhura nga puna, si dhe të ardhurat nga ish-kunata e saj, znj. P. K., dhënë djalit të subjektit të rivlerësimit për qëllime studimi. Subjekti pretendon se Komisioni ka kryer analizë financiare për shpenzime të kryera pas vitit 2016 dhe pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, ndërkohë që nuk ka paraqitur asnjë arsye që e ka bërë të nevojshme kryerjen e analizës për elementë që kronologjikisht i përkasin periudhës pas janarit 2017. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni e ka bazuar vendimin në pagesën e studimeve për të birin, kryer për periudhën 2017-2018, teksa në rastin e saj mungon referenca te pamjaftueshmëria e *cash*-it të deklaruar në deklaratën *vetting* dhe e konstatuar gjatë hetimit, sipas qëndrimit tashmë të konsoliduar të Kolegjit në çështje të mëparshme⁷.

12.7. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk plotësohet asnjë prej kriterëve kushtetuese të parashikuara në pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për shkarkim e saj nga detyra dhe se aplikimi i nenit 61, pikat 3 dhe 5 e ligjit nr. 84/2016, si shkak shkarkimi, bazuar vetëm në kriterin e pasurisë është i pabazuar në prova dhe në zbatim të gabuar të ligjit. Sipas ankueses, në analizë të rasteve të parashikuara të nenit 33 të ligjit nuk ekziston asnjë prej situatave ligjore që do të çonte subjektin e rivlerësimit drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra dhe arsyetimi i Komisionit në vendim nuk rezulton të ketë analizë të provave dhe fakteve të administruara në proces, në funksion të një interpretimi që u duhej bërë normave kushtetuese dhe ligjore mbi të cilat bazohet vendimmarrja.

⁷ Subjekti i referohet vendimit nr. 8, datë 09.03.2021, të Kolegjit për subjektin e rivlerësimit Idriz Mulkurti.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

13. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, znj. Alketa Zifla, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

14. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

15. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 401, datë 16.06.2021, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
16. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja dhe kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, vendosi të refuzojë kërkesën për marrjen e provave të reja, pasi nga analiza e kryer në kuadër të parashikimeve të nenit 47, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012, në konsideratë edhe të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” e “d” të ligjit nr. 84/2016, u arrit në përfundimin se nuk plotësohen kërkesat e dispozitave procedurale të sipërcituara sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim ose në parashtrimet me shkrim, sipas nenit 49, pika 2 e të njëjtit ligj, fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision si dhe ato u konsideruan të panevojshme pasi nuk ndikonin në zgjidhjen e çështjes. Gjithashtu trupi gjykues pasi kontrollloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet dokumentacionit të fashikullit të

Komisionit, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të ankueses. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së kryer lidhur me kërkesën e subjektit për marrjen e provave të reja, në kuadër të kërkimit të tij në ankim për shqyrtimin e çështjes në seancë publike, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49, të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni

17. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të kryer në Komision, trupi gjykues i trajtoi në mënyrë të integruar, në kuadër të analizës së shkaqeve të ngritura në ankim lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe, për rrjedhojë, në këtë vendim ato nuk janë analizuar si shkaqe të pavarura të ankimit.

Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

18. Në lidhje me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 59 m², në Tiranë, Komisioni në vlerësimin në tërësi të veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzionin se: *Subjekti ndërmori një sërë veprimesh fiktive me qëllim përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, përdori shkaqe të paligjshme në hartimin e kontratave, shfrytëzoi politikat sociale strehuese të zbatuara nga Bashkia Fier për qytetarët e saj të pastrehë, për të blerë apartament në Tiranë, kundrejt një vlere shumëfish më të lartë sesa ajo e përcaktuar për banesat me kosto të ulët, nuk e përdori apartamentin për strehim, por lejoi prindërit të banonin në të, mori pjesë në hetimin e një çështjeje me Bashkinë Fier në kushtet e konfliktit të interesit. [...] të gjitha këto veprime nuk përputhen me sjelljen etike të një magjistrati, i cili duhet të shfaqë integritet të lartë, si gjatë ushtrimit të detyrës të saj, ashtu edhe jashtë veprimtarisë hetimore, duke marrë në konsideratë autoritetin dhe reputacionin që subjekti i rivlerësimit përfaqëson. [...] Subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programeve të trajnimit në kuptim të këtij neni, pasi me veprimet dhe mosveprimet e saj ka cenuar integritetin dhe autoritetin e organeve të drejtësisë”.*

19. Ky konkluzion i Komisionit është bazuar në:

(a) Faktin e kryerjes së një sërë veprimesh të simuluar nga subjekti, të cilat nuk kanë pasur qëllim ardhjen e pasojave juridike, për të cilat Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës mbi kryerjen e veprimeve juridike të simuluar. Përkundrazi, gjatë hetimit administrativ si dhe në përfundim të tij, rezultoi i qartë vullneti i subjektit për kryerjen e këtyre veprimeve në marrëveshje me prindërit e saj vetëm për përfitimin e kredisë. Ky konkluzion është i bazuar edhe në praktikën e konsoliduar, tashmë, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit në lidhje me trajtimin e elementeve fiktive në rastet e kredive me kushte lehtësuese. (Vendim i KPA-së nr. 28/2019 JR, datë 30.10.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Ervin Metalla).

(b) Faktin e përdorimit të kredisë me kushte lehtësuese për strehim jashtë juridiksionit territorial të Bashkisë Fier dhe ndërmarrjen e një sërë veprimesh juridike vetëm në funksion të plotësimit formal të kushteve me qëllim përfitimin e kredisë lehtësuese, Komisioni ka arritur në konkluzion se, subjekti me veprimet e kryera ka pasur qëllim përfitimin e kredisë dhe jo strehimin brenda juridiksionit territorial të Bashkisë Fier në një banesë me kosto të ulët, sikurse kërkohet nga ligji nr. 9232, datë 13.05.2004 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, duke qenë se nga hetimi rezultuan fakte të pakundërshtueshme si: i) Përdorimi i kredisë për blerjen e apartamentit në Tiranë kundrejt çmimit 11.210.000 lekë në kushtet kur për shkak të natyrës së kredisë lehtësuese, vlera e banesës, ishte përcaktuar nga Ministria e Punëve Publike dhe e Transportit në shumën 4.487.520 lekë, si banesë me kosto të ulët; ii) Subjekti e kishte fituar pronësinë mbi apartamentin, objekt kreditimi që në datën 09.03.2012 dhe çmimi sipas kontratës së shitblerjes në shumën 11.210.000 lekë ishte paguar plotësisht. Ndërkohë, kontrata e kredisë është lidhur më vonë, në datën 27.03.2012 dhe në vijim, në datën 30.03.2012 është disbursuar kredia në shumën 3.452.000 lekë për t'iu kaluar prindërve të subjektit në datën 03.04.2012. Veprimet e njëpasnjëshme të subjektit me përmbajtje fiktiviteti nuk i përshtaten aspak figurës së një magjistrati, të cilit ligji i ka dhënë të gjitha garancitë e nevojshme për krijimin tek publiku të modelit të një drejtësie të paprekshme.

(c) Përdorimin nga subjekti të interesave të përfutur nga investimi i fondit të kredisë së marrë nga BKT-ja nga prindërit e saj, për të ripaguar interesat e kësaj kredie gjatë viteve, si dhe mosdeklarimin në deklaratat e pasurisë si të ardhura të dhuruara nga prindërit, sipas nenit 4, pika "f" e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. Për rrjedhojë, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit. Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të deklaruar në deklaratat periodike 2012-2016, si dhe në deklaratën vetting të ardhurat e dhuruara nga prindërit, sipas nenit 43 pika "f" e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, ku parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale.

(ç) Vlerësimin e rrethanave të përfshirjes së subjektit në hetimin e çështjes, procedimit penal nr. {***/2012, ndaj disa zyrtarëve të lartë të Bashkisë Fier, në kuptim të neneve 37, 18, 26 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, ligjit nr. 9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, Komisioni ka arritur në konkluzionin se, bazuar në faktet dhe provat e rezultuara nga hetimi, shpjegimet e subjektit, si dhe pas kryerjes së analizës ligjore, subjekti ishte në kushtet e konfliktit të interesit e, për rrjedhojë, duhet të hiqte dorë nga hetimi i procedimit penal nr. {***/2012, sipas nenit 26 dhe nenit 17, pika "ë" e Kodit të Procedurës Penale.

20. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit në lidhje me pasurinë apartament banimi duke pretenduar se qëndrimi i Komisionit lidhur me veprimet juridike, është i pambështetur në prova e në ligj dhe se vendimi është marrë në kundërshtim me parashikimet e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 80, 81 dhe 87 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti e bazoi kundërshtimin e saj në argumentet si vijojnë.

20.1. Është fakt i provuar se ndërmjet saj dhe prindërve të saj është dakordësuar kalimi i pronësisë së apartamentit me numër pasurie {***}, vol. {***}, faqe {***}, Z.K {***}, me sipërfaqe 59 m², i cili është blerë nga ankuesja nëpërmjet kontratës së kredisë bankare nr. {***} rep., {***} kol., datë 21.12.2011, dhe është regjistruar rregullisht pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë.

20.2. Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë se një nga kriteret paraprake të bankës për nënshkrimin e kontratës së kredisë bankare ka qenë mbulimi i vetëm 80% të vlerës së subvencionuar nga bashkia dhe se ajo, mbi këtë kërkesë të bankës, ka nënshkruar me prindërit e saj kontratën e kaparit nr. {***} rep., {***} kol., datë 21.12.2011.

20.3. Edhe pse mes palëve është nënshkruar deklarata noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 21.12.2011, në të cilën përcaktohet, ndër të tjera, se: *realisht nuk kemi marrë nga vajza jonë kaparin prej 1.500.000 lekësh, por e kemi bërë vetëm për ta ndihmuar atë në blerjen e apartamentit të cituar në kontratë*, dhe nuk është ekzekutuar kontrata e kaparit, qëllimi i tyre ka qenë kalimi i pronësisë së pasurisë së paluajtshme objekt verifikimi.

20.4. Një veprim i tillë juridik, i vlerësuar si “i simuluar” nga Komisioni, është realizuar si një kërkesë eksplicite e bankës në kuadër të konkretizimit dhe finalizimit të marrëdhënies kontraktore të kredisë midis saj në cilësinë e kredimarrësit dhe Bankës Kombëtare Tregtare në cilësinë e kredihënësit dhe është përdorur vetëm gjatë procesit të verifikimit të ekzistencës së kushteve për konkretizimin e marrëdhënies së kredisë bankare si një kërkesë formale nga ana e bankës. Ky fakt, sipas subjektit, nuk mund të përbëjë shkak për shkarkimin e saj nga detyra duke pretenduar se një qëndrim i tillë përbën një praktikë të konsoliduar të Komisionit⁸.

20.5. Në ndryshim nga sa parashtrohet Komisioni, “vesimi” i veprimit juridik, pra i kontratës së kaparit, nuk cenon vlefshmërinë e veprimeve të tjera juridike dhe nuk passjell pavlefshmërinë e kontratës bankare me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2012 dhe as të kontratës së shitblerjes me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 09.03.2012, pasi ato janë veprime juridike të ndara me objekte dhe shkaqe ligjore të ndryshme.

20.6. Komisioni ka cenuar parimin e proporcionalitetit kur në trajtimin e çështjes ka vlerësuar *apriori* pavlefshmërinë e veprimeve juridike si të simuluar, pa marrë në konsideratë rrethanat, shkaqet e nënshkrimit të kontratës së kaparit, qëllimet e përdorimit të saj dhe kohën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

20.7. Nga ana e Komisionit, nuk i është kaluar barra e provës dhe nuk është njohur më parë me konstatimin se nga administrimi i dokumentacionit nga BKT-ja, gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi ndonjë kriter bankar “garantor” i natyrës së kaparit lidhur me përfitimin e kredisë, dhe se për sigurimin e përmbushjes së detyrimit sipas kredisë, ishte vendosur hipotekë/kolateral vetë apartamenti për blerjen e të cilit ishte marrë kredia. Në këto kushte, subjekti pretendon se, pas njohjes me vendimin e arsyetuar, ka kërkuar informacion nga banka, e cila në përgjigjen e

⁸ Subjekti i rivlerësimit i referohet vendimit nr. 218, datë 10.12.2019, të Komisionit.

saj⁹ saktëson domosdoshmërinë e kontratës së kaparit në interes të qëllimit të marrjes së kredisë bankare.

21. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstatoi si vijon.

21.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *apartament banimi me sipërfaqe 59 m², bulevardi “{***}”, lagjja “{***}”, shk. {***}, ap. {***}, identifikuar me nr. pasurie {***}, ZK.{***}, sipas kontratës së shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.03.2012”, vlera 11.210.000 lekë, zotëron 50%.*

21.2. Si burim të ardhurash për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar kredi me kushte lehtësuese, të përfituar nga Bashkia Fier dhe BKT sipas kontratës bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2012, në shumën 3.452.000 lekë, si dhe ka sqaruar se pjesa tjetër e çmimit të shitjes nuk u është dorëzuar prindërve të saj sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.03.2016.

21.3. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “apartament banimi”, me sip. 59 m², të ndodhur në Tiranë, bulevardi “{***}”, pallatet “{***}”, shk. {***}, ap. {***}, identifikuar me numër pasurie {***}, z.k. {***}, blerë me kredi me kushte lehtësuese nga Bashkia Fier dhe BKT, vlera 3.452.000 lekë, pjesa takuese 100%.

21.4. Në sqarimet e dhëna pranë ILDKPKI¹⁰-së më datë 29.03.2016, në lidhje me mospërputhjen e çmimit të deklaruar në shumën 3.452.000 lekë dhe çmimit në kontratën e shitjes në shumën 11.210.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *[...] apartamenti është rivlerësuar, është vendosur në kontratën e shitblerjes çmimi 11.210.000 lekë, apartament i ngarkuar me barrë hipotekore në favor të kredisë së marrë në datën 03.04.2012, në shumën 3.452.000 lekë.*

21.5. Nga informacioni i administruar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Jug¹¹, ka rezultuar se pasuria është regjistruar në datën 17.03.2012 në pronësi të subjektit të rivlerësimit, mbi bazën e kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.03.2012, të lidhur ndërmjet prindërve të subjektit të rivlerësimit, z. H. Ll. dhe znj. L. Ll. në cilësinë e shitësve dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e blerësit. Sipas kësaj kontrate, prindërit i kalojnë subjektit pronësinë mbi pasurinë “apartament banimi” me sip. 59 m², kundrejt çmimit 11.210.000 lekë, i paguar jashtë zyrës noteriale.

21.6. Nga aktet e fashikullit të çështjes, konstatohet se për fitimin e kësaj pasurie, midis subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, në cilësinë e blerëses dhe prindërve të saj si palë shitëse janë lidhur kontratat noteriale dhe janë bërë deklaratat noteriale vijuese.

⁹ Shkresën nr. {***} prot., datë 10.08.2021, të Bankës Kombëtare Tregtare, të cilën subjekti i rivlerësimit ia ka bashkëlidhur ankimit duke kërkuar marrjen e saj në cilësinë e provës së re.

¹⁰ Procesverbal i përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 11.03.2021.

¹¹ Kërkesë për informacion e Komisionit nr. {***} prot., datë 11.09.2019, drejtuar ASHK-së, si dhe kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 03.10.2019 dhe dokumentacioni shoqëruar ku rezultojnë të regjistruara dy pasuri, pasuria me nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, z.k. me nr. {***}, lloji i pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 18,10 m², që ka vijuar në vol. {***}, f. {***}, z.k. me nr. {***}, si dhe pasuria me nr. {***}, z.k. me nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, z.k. {***}, lloji i pasurisë apartament banimi me sip. 59 m².

i. Kontratë kapari me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2011, ku babai dhe nëna e subjektit shfaqen në cilësinë e marrësit të kaparit dhe subjekti në cilësinë e dhënësit të kaparit. Sipas kësaj kontrate, palët do të siguronin përmbushjen e detyrimit për likuidimin e çmimit të shitblerjes së apartamentit në shumën 5.000.000 lekë. Në këtë kontratë, subjekti deklaroi se i ka dhënë babait të saj kaparin prej 1.500.000 lekësh, ndërsa shuma prej 3.500.000 lekësh do t'i paguhet pas përfitimit të kredisë bankare.

ii. Në të njëjtën datë me nënshkrimin e kontratës së kaparit, pra më datë 21.12.2011, babai dhe nëna e subjektit kanë lëshuar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., në të cilën kanë deklaruar se, pavarësisht se kanë lidhur kontratën e kaparit¹², realisht nuk kanë marrë nga vajza e tyre kaparin në vlerën 1.500.000 lekë, por e kanë bërë këtë deklaram vetëm për ta ndihmuar atë në blerjen e apartamentit.

iii. Kontrata e shitjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 09.03.2012, midis subjektit dhe prindërve të saj për blerjen e apartamentit kundrejt çmimit 11.210.000 lekë, çmim i cili deklarohet të jetë paguar jashtë zyrës noteriale.

iv. Kontratë kredie bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2012, nënshkruar midis kredihënësit BKT ShA dhe kredimarrëses Alketa Zifla, në vlerën 3.452.000 lekë.

v. Deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.03.2016, me deklarues H. dhe L. Ll. ku, ndër të tjera, deklarojnë se: *Nga vajza jonë kemi marrë vetëm shumën prej 3.452.000 lekësh, që përfaqëson çmimin përfundimtar të shitjes së pasurisë [...]. Këtë shumë vajza jonë e ka përfituar nga kredia e lehtësuar nga Bashkia Fier pranë BKT-së. Shuma prej 3.452.000 lekësh ka kaluar në llogarinë tonë bankare pranë BKT-së, datë 03.04.2012.*

vi. Deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.08.2016, e lëshuar nga prindërit e subjektit¹³, sipas së cilës ata janë shprehur se pasuria apartament bashkë me shtesën i janë shitur të dyja subjektit në vlerën 3.452.000 lekë.

21.7. E pyetur nga Komisioni, në lidhje me mospërputhjen e çmimit të blerjes së apartamentit, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet për pyetësin standard, ka deklaruar se: *Në lidhje me deklaramin e apartamentit me nr. pasurie {***}, në rr. “{***}”, me sipërfaqe 59 m², në vitin 2012, sqaroi se vlera e paguar për këtë pasuri, në drejtim të prindërve të mi, ka qenë vetëm 3.452.000 lekë. Kështu, vlera e shënuar në kontratën e shitjes, në shumën 11.210.000 lekë, është pasqyruar për shkak se pasuria e paluajtshme ka qenë paraprakisht e rivlerësuar në datën 08.03.2012, nga shitësit, në shumën 11.210.000 lekë, edhe pse ajo është blerë prej tyre në vitin 1995, në shumën 1.400.000 lekë. Në këto kushte, zyra noteriale, në referencë të vërtetimeve të pronësisë ku pasqyrohej vlera e pasurisë prej 11.210.000 lekësh, e kushtëzoi dokumentacionin ligjor të kontratës së shitjes në respektim të dispozitave detyruese, duke vendosur veton për paraqitjen e vlerës së shitjes në shumën 11.210.000 lekë. Pra, vlera reale e shitjes ka qenë në shumën 3.452.000 lekë, shumë të cilën e kam kaluar nëpërmjet transfertës bankare e që përkon me momentin e disbursimit të kredisë bankare prej BKT-së në emrin tim. Po ashtu, në përgjigjet*

¹² Kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2011.

¹³ Nga dosja e legalizimit bashkëlidhur shkresës kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 11.06.2020, ASHK Tiranë.

për pyetësoin nr. 2, subjekti ka sqaruar se kontrata e kaparit e datës 21.12.2011 përbënte një nga kriteret e veçanta që kërkohej nga banka, për përfitim të kredisë¹⁴.

21.8. Për të provuar shpjegimet në lidhje me çmimin, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës 11 kontrata të ngjashme të lidhura pas hyrjes në fuqi të udhëzimit nr. 9, datë 26.02.2008, të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.03.2016, lëshuar nga H. e L. Ll., të cilat janë administruar nga Komisioni.

21.9. Sa i takon burimit të krijimit të kësaj pasurie, nga analiza e dokumentacionit bankar të administruar, ka rezultuar se në datën 27.03.2012, është lidhur kontrata e kredisë bankare me nr. {***} rep., nr. {***} kol., midis subjektit në cilësinë e kredimarrësit dhe BKT-së në cilësinë e kredidhënësit, si dhe z. M. Z. dhe z. E. Z. në cilësinë e dorëzanësve, me objekt kreditimin në shumën 3.500.000 lekë. Në aneksin e çeljes dhe përdorimit të kredisë, pika 2 e tij, është

¹⁴ Në lidhje me kontratën e kaparit të datës 21.12.2011, deklaroj se nga ana ime nuk është kryer asnjë pagesë e shumës së përcaktuar në të, për vlerën 1.500.000 lekë. Kjo, për shkak të marrëdhënies sonë të posaçme familjare dhe pasojë e vendimeve të prindërve të mi, në lidhje me rregullimet e vlerave financiare të familjes së tyre, të bëra me të drejtën dhe vullnetin e tyre të plotë, në favor dhe midis pasardhësve të tyre (në formën e një ndarjeje pasurie apo testamenti), duke marrë në konsideratë nevojat përkatëse të secilit. Nisur nga kushtet dhe kërkesat që kishin prindërit tanë ndaj nesh si pasardhës, në atë moment e në vijim, kemi rënë dakord që ata do të vijonin të jetonin në të njëjtën shtëpi, deri në përfundim të katit shtesë sipër këtij apartamenti, për të cilin prindërit e mi, qysh prej bërjes së atij apartamenti, ishin në përpjekje e sipër për të plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për të ndërtuar një apartament banimi sipër apartamentit të shitur tashmë, në të cilin do të kalonin të jetonin ata pasi ai të realizohej. Në momentin e nënshkrimit të kontratës së kaparit, ne kemi vlerësuar se koha deri në përfundimin e kësaj shtese nuk do të zgjaste më shumë se 10 vjet, kohë gjatë së cilës prindërit e mi do të jetonin në apartamentin që shitën, së bashku me mua. Vlerësimet përfundimtare dhe rregullimet apo kompensimet në lidhje me pagesën e plotë të shumës 5.000.000 lekë, për apartamentin e shitur me kontratë, duke marrë në konsideratë edhe periudhën e qëndrimit të prindërve në apartamentin e shitur prej tyre, do të bëhen me realizimin e shtesës mbi këtë apartament ku ata edhe do të kalojnë të jetojnë. Faktin që unë nuk kam paguar asnjë vlerë financiare për shumën 1.500.000 lekë në lidhje me kontratën e kaparit të datës 21.12.2011, e konfirmoj edhe deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2011, e bërë nga prindërit e mi, ku deklarojnë që shumën e kaparit të përcaktuar në vlerën 1.500.000 lekë, nuk e kanë marrë asnjëherë prej meje. Sa i përket çmimit të kontratës së shitjes të datës 09.03.2012, me vlerën prej 11.210.000 lekësh, sqaroj se ky çmim është vendosur nga noteri duke u bazuar në udhëzimin e përbashkët nr. 9, datë 26.02.2008, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Financave, pika 11, e cila detyron zyrtarë noteriale me pasojë penalizimi, për respektimin e çmimeve minimale fiskale të përcaktuara. Në rastin konkret, çmimi minimal fiskal i kontratës së shitjes të datës 09.03.2012, është përcaktuar dhe vendosur në kontratë nga noteri, pasi për këtë apartament, është shlyer më parë edhe tarifa e rivlerësimit të kësaj pasurie, të cilën noterja e konstatoi në kartelën e pasurisë. Kështu, ajo detyroi dhe vendosi paraqitjen e këtij çmimi shitjeje edhe në kontratë, pasi ai përkonte pikërisht me çmimin minimal fiskal të pasurisë në zonën përkatëse. Duke qenë se nga ana jonë si palë kontraktore, për shkak të lidhjes sonë të posaçme, nuk kishte shumë interes për vlerën e cila do të shënohej në kontratë, çfarëdo qoftë ajo, pasi pagesa e vlerës së shkruar në këtë kontratë nuk do të bëhej asnjëherë, dhe shuma prej 3.500.000 lekësh që do të paguhej, do të lëvrohej ditë më vonë pas lidhjes së kontratës së kredisë dhe disbursimit të saj prej bankës, të ndodhur në kushtet e kërkesave tepër të ngurta të departamentit ligjor të bankës, në mirëbesim të plotë midis nesh si palë kontraktore, pranuar të nënshkruajmë këtë kontratë shitblerjeje me qëllimin e vetëm që të bëhej kalimi i pronësisë dhe regjistrimi i saj në emrin tim si blerëse, për t'i dhënë mundësi bankës për ta vendosur si kolateral këtë pasuri në emrin tim. Faktin që unë nuk kam paguar asnjë vlerë financiare për shumën 11.210.000 lekë në lidhje me kontratën e shitjes së datës 09.03.2012, e konfirmoj edhe deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.03.2016, e bërë nga prindërit e mi, ku deklarojnë që shumën e përcaktuar në këtë kontratë, në vlerën 11.210.000 lekë, nuk e kanë marrë asnjëherë prej meje.

përcaktuar se: *Kreditimi do të përdoret nga kredimarrësi për blerje shtëpie*. Gjithashtu, në aneksin e elementeve specifike të kredisë, është përcaktuar se shuma prej 3.500.000 lekësh do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit dhe shuma e disbursuar do të transferohet nga llogaria e kredisë në favor të shitësit të objektit të kredituar H. Ll. dhe L. Ll., me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së.

21.10. Për sigurimin e përmbushjes së detyrimit, është lidhur kontrata e hipotekimit me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2012, sipas së cilës, në favor të bankës BKT, është vendosur hipotekë mbi pasurinë e shitur subjektit. Nga aktet e çështjes¹⁵, rezulton se më datë 28.03.2012, është regjistruar hipoteka mbi pasurinë në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe, pas regjistrimit të hipotekës, më datë 30.03.2012, është disbursuar kredia nga BKT-ja¹⁶. Referuar lëvizjeve të llogarive, *statement*, të vëna në dispozicion nga kjo bankë, ka rezultuar se shuma e kredisë në vlerën 3.452.000 lekë është transferuar në datën 03.04.2012 në llogari të prindërve të subjektit.

21.11. Rezulton se si burim krijimi i kësaj pasurie, ka shërbyer kredia me kushte lehtësuese e përfituar nga subjekti i rivlerësimit si e pastrehë në Bashkinë Fier, bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar. Më datë 28.02.2011, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Bashkia Fier trajtimin me banesë me kosto të ulët në kushtet kur nuk kishte përfituar banesë nga ligji për privatizimin e banesave dhe kishte statusin e të pastrehut. Rezulton se në kohën e paraqitjes së kërkesës, subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, ishte prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ishte e martuar me tre fëmijë, si dhe e regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile Fier dhe banonte në një apartament me qira. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kërkuar të trajtohet me strehim sipas VKM-së 600/2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, por si qytetare e Bashkisë Fier, me statusin e të pastrehut dhe në pamundësi financiare për përbalimin e një kredie në kushte tregu. Në këtë procedurë, nga subjekti nuk është kërkuar strehimi në qytetin e Fierit, por vetëm trajtimi me kredi me kushte lehtësuese si banore e tij dhe jo si prokurore. Subjektit dhe familjes së saj (me 5 anëtarë)¹⁷ i është miratuar kredia nga Këshilli Bashkiak Fier në vlerën 3.500.000 lekë, me afat 20-vjeçar dhe normë interesi 3% në muaj. Nëpërmjet kësaj kredie, të disbursuar më datë 30.3.2012, subjekti ka paguar çmimin për blerjen e apartamentit objekt analize.

21.12. Sipas ligjit nr. 9232/2004 dhe udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 6257/2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, programet sociale të strehimit kanë për fokus familjet apo individët të cilët për shkaqe ekonomike e sociale nuk mund të përballojnë çmimet e banesave në treg apo ato të kredive hipotekore. Ligji mundëson ndihmën e shtetit për të krijuar kushte strehimi të përshtatshme dhe të përballueshme

¹⁵ Kontratë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2012 si dhe anekset bashkëlidhur, kontratë hipotekimi me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2012, si dhe *statement-et* bankare, datë 01.03.2016.

¹⁶ Kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 27.09.2019, nga Banka Kombëtare Tregtare.

¹⁷ Referuar shkresës nr. {***}, datë 06.04.2021, të Bashkisë Fier, sipas listës së Entit të Banesave të familjeve të pastreha që kanë përfituar nga programi social i kredisë së lehtësuar nga shteti për blerjen e banesave me kosto të ulët.

për familjet në nevojë. Në nenin 3 të këtij ligji, janë përcaktuar tri lloje programesh sociale të familjeve në nevojë, që përfshijnë: (i) programe të banesave sociale me qira [...]; (ii) programe të banesave me kosto të ulët; si dhe (iii) programe të pajisjes së truallit me infrastrukturë. Subjekti dhe familja e saj rezultojnë të kenë përfituar këtë trajtim mbi bazën e pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 9232/2004, me statusin e të pastrehut, dhe nuk është konstatuar ndonjë kriter skualifikues për subjektin e rivlerësimit për përfitimin e kësaj kredie të miratuar nga Bashkia Fier dhe të ekzekutuar nga Banka Kombëtare Tregtare, si institucioni financiar kredidhënës sipas kontratës së kredisë së datës 27.03.2012.

21.13. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredi me kushte lehtësuese me statusin e të pastrehut sipas ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” dhe nuk është konstatuar ndonjë parregullsi në drejtim të përmbushjes së kriterëve ligjore dhe rrethanave të përfitimit të kredisë, të cilën subjekti e ka përdorur për strehim në përputhje me qëllimin e vetë ligjit¹⁸.

22. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit me të cilin ai kundërshtoi konkluzionin e Komisionit në lidhje me veprimet juridike të konsideruara të simuluar/fiktive dhe çmimin e kontratës së shitjes së apartamentit të banimit si të pambështetur në ligj e në prova, i arritur në kundërshtim me parashikimet e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 80, 81 dhe 87 të Kodit të Procedurave Administrative.

22.1. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe kontrollit të bazueshmërisë në fakte dhe në ligj të vendimit të Komisionit lidhur me çështjen objekt kontrolli, trupi gjykues vëren se konkluzionin e mësipërm, Komisioni e ka bazuar në faktet që i referohen lidhjes së kontratës së kaparit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2011, dhe çështjes së çmimit të apartamentit, të cilat, sipas vlerësimit të Komisionit, përmbajnë elemente të fiktivitetit pasi janë hartuar dhe nënshkruar nga palët vetëm në funksion të përfitimit të kredisë, pa pasur qëllim ardhjen e pasojave juridike.

22.2. Trupi gjykues vëren se, referuar akteve në fashikullin e Komisionit, konstatohet se subjekti ka nënshkruar me prindërit e saj kontratën e kaparit të datës 21.12.2011, ku ishte parashikuar shitblerja e apartamentit kundrejt çmimit prej 5.000.000 lekësh. Në këtë kontratë, deklarohet se subjekti u ka dhënë prindërve të saj kaparin prej 1.500.000 lekësh, ndërsa pjesa tjetër e çmimit, në shumën prej 3.500.000 lekësh, deklarohet se do të paguhej pas përfitimit të kredisë bankare. Rezulton se, në të njëjtën datë me lidhjen e kontratës së kaparit, prindërit e subjektit kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., sipas së cilës kanë deklaruar se, pavarësisht lidhjes së kontratës së kaparit, realisht nuk kanë marrë nga vajza e tyre kaparin në vlerën 1.500.000 lekë, por e kanë bërë këtë deklaram vetëm për ta ndihmuar atë në

¹⁸ Kushtet dhe kriteret e përfitimit për programet e strehimit kanë qenë të parashikuara në kreun V, neni 17 e vijues, si dhe neni 25 i këtij ligji. Konkretisht, në nenin 18 të këtij ligji përcaktohen kriteret mbi bazën e të cilave përfitonin të pastrehët: “[...] a) familjet që në çastin e paraqitjes së kërkesës pranë zyrës përkatëse të bashkisë nuk kanë në pronësi një banesë [...]”. Gjithashtu, në dispozitat e përgjithshme në lidhje me kriteret përfituese të programeve sociale, në nenin 5, “Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve”, përcaktohet se trajtohen me përparësi: a) familjet, të cilat vërtetojnë se nuk kanë përfituar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

blerjen e apartamentit. Në vijim, rezulton se, sipas kontratës së shitblerjes së datës 9.3.2012, çmimi i shitjes së kësaj pasurie është 11.210.000 lekë, një çmim disa herë më i lartë se ai i dakordësuar në kontratën e kaparit. Rezulton po ashtu se edhe ky çmim është konsideruar formal nga palët sipas deklaratës noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.03.2016, me deklarues H. dhe L. Ll., të cilët deklarojnë se: *Nga vajza jonë kemi marrë vetëm shumën prej 3.452.000 lekësh, që përfaqëson çmimin përfundimtar të shitjes së pasurisë. [...] Këtë shumë vajza jonë e ka përfutuar nga kredia e lehtësuar nga Bashkia Fier pranë BKT-së. Shuma prej 3.452.000 lekësh ka kaluar në llogarinë tonë bankare pranë BKT-së, datë 03.04.2012.* Më tej, referuar deklaratës noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.08.2016, të lëshuar nga prindërit e subjektit, deklarohet se pasuria apartament i është shitur subjektit të rivlerësimit së bashku me shtesën anësore me sipërfaqe 18,1 m², në vlerën totale 3.452.000 lekë.

22.3. Në vlerësim të situatës së mësipërme, duket se palët, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së kaparit përpara noterit publik, kanë shfaqur vullnetin që të hyjnë në një marrëdhënie shitblerjeje duke përcaktuar si objekt shitjeje apartamentin me numër pasurie {***}, vol. {***}, faqe {***}, z.k. {***}, me sip. 59 m², me çmim shitjeje 5.000.000 lekë, për ekzekutimin e së cilës deklarohet se është dhënë kapar në shumën 1.500.000 lekë, ndërkohë që pjesa tjetër e këtij çmimi prej 3.500.000 lekësh do të paguhej pas përfitimit të kredisë bankare. Referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, deklaratave noteriale të prindërve të saj, si edhe kontratës së shitjes së kësaj pasurie, rezulton se, përkundër vullnetit të shprehur në kontratën e kaparit, në fakt kapari i deklaruar si i paguar, nuk është dhënë asnjëherë prej subjektit të rivlerësimit dhe njëkohësisht rezulton se çmimi real i apartamentit nuk ishte ai i përcaktuar në kontratën e kaparit, madje as ai i përcaktuar në kontratën e shitjes, pasi çmimi i paguar për këtë pasuri deklarohet të jetë në vlerën 3.425.000 lekë.

22.4. Rezulton se palët kanë kryer një veprim juridik përpara noterit, të cilin e kanë sqaruar menjëherë nëpërmjet deklaratës noteriale të së njëjtës datë, si edhe nëpërmjet veprimeve të tjera noteriale, duke nënkuptuar se ato vetë nuk i kanë dëshiruar pasojat e kontratës së kaparit, por veprimi juridik ka qenë formal, në funksion të kreditimit nga banka. Referuar sa më sipër, trupi gjykues vëren se Komisioni ka konstatuar drejt situatën faktike në lidhje me veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit sipas kontratës së kaparit, për sa rezulton e provuar dhe e pranuar nga vetë subjekti, por edhe prindërit e saj, se dy kushtet themelore të kontratës së kaparit që janë: dhënia e vlerës 1.500.000 lekë si kapar dhe çmimi i pasurisë në masën 5.000.000 lekë, nuk qenë reale, por kontrata është lidhur me qëllimin e vetëm për t'iu paraqitur bankës në funksion të procedurave të përfitimit të kredisë. Çmimi prej 5.000.000 lekësh, i vendosur në kontratën e kaparit, ka përbërë një shifër të përlllogaritur nga palët me qëllim përshtatjen me kushtet e bankës për financimin e kredisë në shumën 3.500.000 lekë dhe kapari prej 1.500.000 lekësh supozohet të përfaqësonte 20% të vlerës së apartamentit për t'u paguar nga vetë blerësi. Në rastin konkret, sikurse është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, palët kanë qenë të ndërgjegjshme dhe kanë rënë dakord që çmimi real i shitjes do të ishte 3.425.000 lekë dhe kontrata e kaparit, ku çmimi i apartamentit përcaktohet në vlerën 5.000.000 lekë, është paraqitur përpara bankës në mënyrë që kredia bankare të mbulonte shumën prej 3.425.000 lekësh.

22.5. Gjatë hetimit administrativ në Komision dhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar rrethanat që e çuan atë drejt nënshkrimit të kontratës së kaparit, duke argumentuar se një veprim

i tillë ishte kërkesë eksplicite e bankës, në kuadër të konkretizimit dhe finalizimit të marrëdhënies kontraktore të kredisë pasi një nga kriteret paraprake të bankës për nënshkrimin e kontratës së kredisë, ka qenë mbulimi i vetëm 80% të vlerës së subvencionuar nga shteti.

22.6. Lidhur me sa më sipër, nga verifikimi dhe analiza e kontratës së kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2012, trupi gjykues konstaton se neni 2 i saj përcakton se banka, me anë të kësaj kontrate kredie, ka akorduar në favor të kredimarrësit një total kreditimi në shumën 3.500.000 lekë. Shuma maksimale e kreditimit është ajo e përcaktuar në listën e sjellë pranë bankës BKT nga institucioni kualifikues i përfituesit kredimarrës. Sipas parashikimeve në këtë kontratë, nëse përfituesi kredimarrës kërkon të financohet me një shumë më të madhe se shumta maksimale e kreditimit, shumta e kredisë jashtë maksimumit të përcaktuar do të trajtohej si kredi me kushtet e tregut. Po ashtu, në nenin 5 të kësaj kontrate rezultojnë të jetë parashikuar se norma e interesit që do të paguhet nga kredimarrësi do të jetë 3%, për sa kohë shumta totale e interesit të subvencionuar nuk kalon totalin e vlerës së pronës objekt blerjeje, të përcaktuar në kontratën e shitjes, e cila në asnjë rast nuk duhet të jetë më e lartë se vlera e apartamentit të përcaktuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, e barasvlershme me 4.487.520 lekë.

22.7. Referuar sa më sipër, trupi gjykues konstaton se, nisur nga përcaktimet e bëra në kontratën e kredisë, kuptohet qartësisht se totali i kreditimit do të ishte në shumën 3.500.000 lekë dhe limiti i vlerës së pronës objekt blerjeje nuk duhet të tejkalonte vlerën prej 4.487.520 lekësh, të përcaktuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit. Referenca në kontratën e kredisë jep informacionin se përcaktimi i vlerës së kredisë, shumta e kreditimit, norma e interesit dhe vlera totale e pronës objekt blerjeje ishin paracaktuar në marrëveshjen midis institucionit përkatës për strehimin dhe bankës si institucion kredidhënës, dhe nuk janë ndikuar nga përcaktimet në kontratën e kaparit. Kjo kontratë mund të ketë shërbyer si dokument justifikues i qëllimit për marrjen e kredisë dhe fillimit të procedurës së shqyrtimit të aplikimit për kredi, megjithatë, referuar akteve në fashikull, ajo nuk ka ndikuar në kushtet për përfitimin dhe shumën e përfituar kredi nga Bashkia Fier. Është fakt i njohur se zakonisht pagesa e kaparit (ose kontributi i kredimarrësit) është kusht për kreditimin sipas rregulloreve/politikave të brendshme të bankave të nivelit të dytë. Pra, është praktikë e bankave që mos të financojnë/kreditojnë 100% të vlerës së objektit të financimit, por rreth 70-80% të tij. Po kështu, edhe sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe ministrit të Financave nr. 6257, datë 02.09.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, i ndryshuar me udhëzimet nr. 2348, datë 17.4.2009 dhe nr. 13, datë 15.6.2010, kufiri maksimal i kreditimit me kushte lehtësuese llogaritet sa 80% e vlerës së apartamentit të blerë në treg. Nëse aplikantët kërkojnë financim në masën 100% të vlerës, atëherë diferenca prej 20% mbulohet me kredi sipas kushteve standarde të bankës. Sipas tabelës nr. 2 të udhëzimit nr. 13, datë 15.6.2010, vlera maksimale e kreditimit për Bashkinë Fier, për një apartament 3+1 (në kushtet kur familja e ankueses ishte e përbërë nga 5 anëtarë) është 4.487.520 lekë, për rrjedhojë 80% e kësaj vlere rezultojnë 3.590.016 lekë. Në vlerësimin e trupit gjykues, lidhja e kontratës së kaparit duket të jetë vlerësuar e domosdoshme nga banka pasi në nenin 4.3 të kontratës së kredisë parashikohet se *kredimarrësi duhet të kryejë pagesën e diferencës midis vlerës së kontraktuar për blerjen e pronës/kolateral dhe vlerës së kredisë, përpara disbursimit të kredisë, në rast të kundërt banka nuk disburson kredinë, dhe kontrata midis palëve*

shfuqizohet duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme. Pra, pretendimi i subjektit se kontrata e kaparit ose pagesa e 20% të vlerës së apartamentit prej blerësit ka qenë kusht për akordimin e kredisë, u vlerësua nga trupi gjykues bindës.

22.8. Kontrata e kaparit e lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të saj për shitjen e apartamentit të ndodhur në Tiranë, është pasuar nga kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.03.2012, për shitjen e kësaj prone, dhe veprimi juridik i kontratës së kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2012, është finalizuar me transaksionin bankar të datës 3.04.2012, ku shuma prej 3.452.000 lekësh, e disbursuar në formën e kredisë, ka kaluar në llogarinë bankare të shitësve, ndërkohë që pronësia mbi pasurinë i ka kaluar subjektit të rivlerësimit.

22.9. Në vlerësim të çështjes nëse nënshkrimi i kontratës së kaparit ka ndikuar apo jo në vlefshmërinë e veprimeve të tjera juridike noteriale të kontratës së shitblerjes dhe kontratës së kredisë bankare, trupi gjykues vlerëson se veprimi juridik i kontratës së kaparit, nuk ka ndikuar në vlefshmërinë e veprimeve të tjera juridike dhe nuk passjell pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 09.03.2012 dhe as të kontratës bankare me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2012, pasi ato janë veprime juridike të ndara me objekte dhe shkaqe ligjore të ndryshme. Në analizë të të gjitha fakteve dhe konkluzioneve të pasqyruara më lart, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, është përfshirë në një sërë veprimesh juridike duke krijuar të drejta e duke marrë përsipër detyrime në funksion të qëllimit, i cili është financimi i një apartamenti banimi, nëpërmjet një kredie me kushte lehtësuese, të subvencionuar nga shteti për një kategori qytetarësh të cilët plotësojnë kriteret e statusit të të pastrehut.

22.10. Në këndvështrimin e trupit gjykues, duket se subjekti ka synuar të ndihmojë ekonominë e saj familjare për të financuar me kushte lehtësuese blerjen e banesës së saj të vetme, si një fakt i cili vjen në përputhje me vetë qëllimin e autoriteteve shtetërore për miratimin dhe implementimin e programeve lehtësuese të strehimit. Verifikimi i këtij qëllimi, nëse ai është në përputhje me vetë qëllimin e dispozitave ligjore që parashikojnë përfitimin e këtyre kredive, në harmoni me veprimet juridiko-civile në të cilat është përfshirë subjekti i rivlerësimit, është pjesë e verifikimeve në kuadër të procesit të rivlerësimit sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi. Në këtë kontekst, qëllimi i deklaruar prej subjektit dhe ndjekja e të gjitha procedurave bankare në përpjekje për të financuar me një kredi lehtësuese blerjen e banesës së saj, për të cilën ajo kishte aplikuar fillimisht për një kredi me kushte lehtësuese, e cila edhe i është akorduar, vjen në përputhje me qëllimin e vetë ligjit. Ajo që duket se prevalon në këtë analizë, është mungesa e qëllimit për të shtuar pasuri apo për t'i siguruar vetes e familjes banesa luksi apo banesa jo të domosdoshme për strehim në kurriz të taksapaguesve e duke shfrytëzuar funksionin.

23. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit që kundërshton konstatimet e Komisionit në lidhje me përdorimin e kredisë me kushte lehtësuese jashtë juridiksionit territorial të Bashkisë Fier, sipas paragrafit 41, pikat b/2 dhe b/3 të vendimit të Komisionit, të cilat, sipas subjektit, janë në interpretim të gabuar të faktit në raport me ligjin nr. 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar.

23.1. Në lidhje me konstatimin e Komisionit për përdorimin e kredisë për blerjen e banesës jashtë juridiksionit territorial të Bashkisë Fier, si dhe ndërmarrjen e një sërë veprimesh juridike vetëm në funksion të plotësimit të kriterit formal të kushteve me qëllim përfitimin e kredisë lehtësuese, si dhe për të analizuar qëllimin e ligjit nr. 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, trupi gjykues vlerësoi të nevojshme të analizojë rregullimet e këtij ligji sa i takon qëllimit, si dhe nëse ka ndonjë përcaktim në lidhje me detyrimin për blerjen e banesës brenda juridiksionit territorial të bashkisë ku kryhet procedura e aplikimit për kredi me kushte lehtësuese.

23.2. Rezulton se ligji nr. 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, ka përcaktuar rregullat dhe procedurat administrative për sigurimin, shpërndarjen, administrimin dhe planifikimin e programeve sociale për strehimin, duke u mbështetur në aftësinë paguese të familjeve dhe kishte për qëllim të lejonte dhe mundësonte që subjektet përfituese të aplikonin për të fituar kredi me kushte lehtësuese për të financuar blerjen e një banese që siguronte strehimin për ta.

23.3. Referuar parashikimeve ligjore të këtij ligji, trupi gjykues vëren se, pavarësisht se mënyra e sigurimit dhe zbatimit të programeve sociale për qëllime strehimi tregojnë se procesi lidhet me popullsinë dhe territorin ku ushtron juridiksionin bashkia përkatëse, ky ligj nuk ka parashikuar shprehimisht se blerja e banesave me kosto të ulët do të kryhet brenda territorit të bashkisë që miraton dhënien e kredisë. Kësisoj, fakti që subjekti ka zgjedhur të blejë një apartament jashtë njësisë territoriale të Bashkisë Fier, nuk rezulton të jetë në kundërshtim me ndonjë kërkesë specifike të ligjit, të bashkisë përkatëse apo bankës. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se një fakt i tillë nuk mund të jetë penalizues për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë ajo nuk rezulton të ketë devijuar nga qëllimi i deklaruar prej saj se, nëpërmjet kredisë me kushte lehtësuese, do të financonte blerjen e banesës së vetme të saj, në përputhje me vetë qëllimin e autoriteteve shtetërore për miratimin dhe implementimin e programeve lehtësuese për strehim. Gjithashtu, nuk konstatohen as elemente që të tregojnë për përpjekje të subjektit për të kamufluar veprime që vijnë ndesh me urdhërimet ligjore në fuqi, me qëllim justifikimin e mungesës së burimeve të ligjshme, si dhe për të mbuluar deformime të deklarimeve të bëra në deklaratën *vetting* apo deklaratat pranë ILDKPKI-së.

23.4. Gjatë hetimit administrativ, si dhe në ILDKPKI, subjekti ka sqaruar rrethanat që e kanë çuar atë në blerjen e apartamentit të prindërve të saj në Tiranë, shpjegime të cilat rezultojnë të jenë bindëse për sa subjekti ka shpjeguar, se blerja e apartamentit të prindërve ishte zgjidhja më e përshtatshme për situatën e saj familjare, si dhe ka bërë me dije planet se si ishte menduar të zhvillohej më tej kjo pronë. Sa më sipër, i krijon bindjen trupit gjykues se, pavarësisht mënyrës se si janë zhvilluar ngjarjet, është situatë faktike e provuar se subjekti ka aplikuar për një kredi me kushte lehtësuese për qëllime strehimi dhe shuma e marrë kredi është përdorur për financimin e banesës së saj sipas kontratës së shitblerjes për apartamentin 59 m² në Tiranë dhe në asnjë moment nuk u provua se kredia e përfituar ka shërbyer për qëllime të tjera. Destinacioni i kredisë, sipas kontratës bankare të marrjes së kredisë, ka qenë përdorimi i saj për blerje apartamenti, destinacioni i cili rezulton të jetë përmbushur. Vetëm fakti se subjekti nuk ka blerë banesë në Bashkinë Fier, por e ka blerë atë në një qytet tjetër, nuk mund të konsiderohet si arsye për të konkluduar se ajo ka devijuar nga qëllimi për strehim. Për më tepër, nuk konstatohet asnjë

element i cili të dëshmojë përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të abuzuar nga përfitimi i kësaj kredie me qëllimin për të shtuar pasuritë e saj apo për realizimin e aktiviteteve që dalin krejtësisht nga qëllimi dhe kushtet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi në kohën e aplikimit për kredi.

24. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit sa i takon konkluzionit të Komisionit në paragrafin 41, pika b.11 e vendimit, sipas të cilit subjekti e kishte fituar pronësinë e apartamentit objekt kreditimi që në datën 9.03.2012 dhe se çmimi, sipas kontratës së shitblerjes, në shumën 11.210.000 lekë ishte paguar plotësisht, duke konstatuar se:

24.1. Ndonëse me veprimet e tyre noteriale, subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj kanë përcaktuar parashikime në lidhje me pagesën e kaparit dhe çmimit të apartamentit, të cilat nuk rezultuan të jenë realizuar asnjëherë plotësisht mes tyre, qëllimi final i palëve për kalimin e pronësisë është i harmonizuar me veprimet konkrete juridike dhe financiare të palëve, pavarësisht ndryshimeve të çmimit të objektit të kontratës. Në këto veprime juridike nuk konstatohen elemente që mund të shkaktojnë pavlefshmëri apo kundërshti me urdhërimet e parashikuara në ligj dhe rrethanat që lidhen me çmimin e apartamentit nuk mund të konsiderohet se kanë afektuar vetë pasojat ligjore që do të prodhonte kontrata e shitblerjes.

24.2. Subjekti ka sqaruar rrethanat në lidhje me përcaktimin e çmimit, si një çmim i detyruar sipas udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë”¹⁹, të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, në zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili ka pasur qëllim rregullimin e përcaktimit të tatimit në rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme. Trupi gjykues konstaton po ashtu se, përpos pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se çmimi është përcaktuar nga noteri bazuar në udhëzimin e mësipërm, nga verifikimi i kryer, rezulton se vlera totale prej 11.210.000 lekësh, vendosur si çmim në kontratën e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 59 m², duket të jetë përlllogaritur në çmimin 190.000 lekë/m², i cili përkon me çmimin referencë të tregut për apartamentet në Tiranë në vitin 2012. Ky vlerësim i trupit gjykues u bazua duke pasur në konsideratë se nga verifikimi i akteve në dosje, rezultoi se, sipas dokumentacionit të përcjellë nga ASHK-ja, pasuria është regjistruar në datë 17.03.2012, mbi bazën e kontratës së shitjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 09.03.2012, ku shitësit, z. H. dhe znj. L. Ll. (babai dhe nëna e subjektit) i kalojnë subjektit pronësinë nëpërmjet shitblerjes mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 59 m², të ndodhur në Tiranë, bulevardi “{***}”, pallatet “{***}”, shk. {***}, ap. {***}, identifikuar me nr. pasurie {***}, z.k {***}, kundrejt çmimit të rivlerësuar të pasurinë në shumën 11.210.000 lekë²⁰.

¹⁹ Ky udhëzim, në nenin 5 të tij parashikon se: “Përcaktimi i vlerës së shitjes bazohet në kontratën e shitjes së pasurisë. Në rastet kur çmimi i shitjes për m² i përcaktuar në kontratë, është më i ulët se çmimi minimal i përcaktuar në shtojcat nr. 2 dhe 3 të këtij udhëzimi, zbatohen këta të fundit për efekt të llogaritjes së tatimit”. Neni 11 i këtij udhëzimi, që referon subjekti, përcakton detyrimin e zyrove noteriale për njohjen dhe respektimin e çmimeve në kontratat e noterizuara të shitjeve të pasurive të paluajtshme, moszbatimi i të cilave do të konsiderohej kundërvajtje administrative.

²⁰ Referuar kartelës së pasurisë, pasuria është rivlerësuar nga shitësit në vlerën 11.210.000 lekë në datën 08.03.2012.

24.3. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se palët në kontratën e shitjes kanë vendosur çmimin e rivlerësimit të apartamentit, por pa kryer pagesë përtej çmimit të paguar nëpërmjet transfertës bankare të datës 03.04.2012.

24.4. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se veprimet e subjektit të rivlerësimit, që kanë shërbyer për të realizuar përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, e përdorur për financimin e apartamentit të banimit me sipërfaqe 59 m², në Tiranë, në tërësinë e tyre nuk janë veprime të cilat janë bazuar në shkaqe të paligjshme. Hartimi i kontratave të kaparit, të shitjes dhe asaj të kredisë bankare ka ardhur si pasojë e vullnetit të palëve kontraktore, në mirëbesimin e tyre, në kuadër të një marrëdhënieje juridiko-civile. Trupi gjykues nuk konstatoi elemente që tregojnë përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të kamufluar veprime që bien ndesh me urdhërimet ligjore në fuqi, për të justifikuar pasuri të fituara me burime të paligjshme apo për të mbuluar deformime në deklaratimet e bëra në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting*.

25. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, nëpërmjet të cilave ajo kundërshton konkluzionin e Komisionit në lidhje me përdorimin e interesave bankarë të përfituar nga prindërit e saj përmes investimit të fondit të kredisë, për shlyerjen e kësteve të kredisë dhe mosdeklarimin në deklaratat e pasurisë të këtyre të ardhurave/dhurimeve, në kundërshtim me pikën 4, germa “f” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, trupi gjykues konstaton si më poshtë vijon.

25.1. Nga analiza e vendimit objekt shqyrtimi, rezulton se konkluzioni i Komisionit lidhet me mosdeklarimin nga ana e subjektit të rivlerësimit të të ardhurave të dhëna prej prindërve të saj në interes të shlyerjes së disa kësteve të kredisë, në kundërshtim me nenin 4, pika “f” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, ku parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Pavarësisht këtij përfundimi, rezulton se fakti i mosdeklarimit të këtyre të ardhurave nga subjekti i rivlerësimit nuk është kualifikuar si problematikë, në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe as nuk është konsideruar si shkak shkarkimi në konkluzionet përfundimtare të Komisionit, në vendim. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit, në lidhje me mosdeklarimin e dhurimeve nga prindërit, nuk ka sjellë pasoja për subjektin në kuadër të procesit të rivlerësimit dhe shqyrtimi i mëtejshëm i pretendimeve të subjektit në lidhje me këtë çështje u vlerësua i panevojshëm.

26. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit sa i takon konkluzionit të Komisionit në lidhje me vlerësimin e rrethanave të përfshirjes së saj në hetimin e kallëzimit penal nr. {***}, datë 16.07.2012, ndaj disa zyrtarëve të Bashkisë Fier, duke konstatuar si vijon.

26.1. Komisioni ka vlerësuar se *subjekti ishte në rrethanat e një konflikti midis interesit privat me atë publik, për shkak të trajtimit të kallëzimit të paraqitur nga 15 qytetarë fierakë ndaj disa zyrtarëve të lartë të Bashkisë Fier dhe për të balancuar këta interesa, në kuptim të krijimit të garancive ligjore për zgjidhjen e drejtë dhe të paanshme të fakteve të paraqitura për zgjidhje, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, subjekti duhet t'i kishte paraqitur dorëheqjen drejtuesit të Prokurorisë, për shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, bazuar në nenin 26 dhe 17, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës*

*Penale*²¹, i cili do të mund të vendoste në lidhje me dorëheqjen apo jo të subjektit nga hetimi i çështjes. Sipas arsytimit të Komisionit, subjekti dështoi të provonte se ndërmoi të gjitha masat, nëpërmjet vënies në lëvizje të këtyre mjeteve ligjore, për rregullimin e heqjes dorë nga çështja.

26.2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, kundërshton në ankim vlerësimin e Komisionit lidhur me rrethanat e përfshirjes së saj në hetimin e procedimit penal nr. {***}/2012 ndaj disa zyrtarëve të Bashkisë Fier, duke pretenduar se: (i) konkluzioni i Komisionit në pikën “d” të vendimit është në kundërshtim me rrethanat e përfitimit dhe përdorimit të kredisë, dhe haptazi i pabazuar në ligj; (ii) në aspektin procedural, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk është njohur më parë dhe nuk i është kaluar barra e provës në lidhje me këtë konkluzion; (iii) Komisioni nuk merr parasysh se gjatë periudhës së trajtimit me kredi lehtësuese nga Bashkia Fier, viti 2011 dhe deri në muajin mars 2012, subjekti nuk ka trajtuar asnjë material kallëzues në lidhje me këtë bashki dhe se gjithë procedura administrative për miratimin e kredisë kishte përfunduar përpara momentit të kallëzimit penal nr. {***}, datë 16.07.2012; (iv) vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nuk është ankimuar prej saj, dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vijuar me regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore, duke konkluduar me dërgimin në gjykatë të disa punonjësve zyrtarë të Bashkisë Fier; (v) në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur deklarimin e pafajshëm të të pandehurve për veprën penale “Shpërdorim detyre”, vendim i cili ka marrë formë të prerë, duke u lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë; (vi) subjekti pretendon se nuk gjendet në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, pasi interesi i saj në dukje ka përfunduar para trajtimit të kallëzimit penal në ngarkim të funksionareve të Bashkisë Fier; (vii) konflikti në dukje i interesit nuk ka ndodhur dhe as ka pasur mundësi që të ndodhte, pasi nuk rezulton asnjë interes i supozuar që të ketë lidhje me vendimmarrjen e saj në kushtet kur, në lidhje me çështjen në fjalë, ka një vendim pafajësie të formës së prerë; (viii) sipas subjektit të rivlerësimit, në rastin e saj nuk ekziston një situatë e konfliktit të interesit e cila, në vështrim të dispozitave të ligjit të posaçëm që rregullon konfliktin e interesit, të vlerësohet si komponent në procesin e rivlerësimit.

26.3. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me rrethanat e përfshirjes së saj në hetimin e kallëzimit penal nr. {***}/2012, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.

²¹ Normimi i situatave të tilla, me qëllim parandalimin e pasojave të padëshiruara, të cilat cenojnë besimin e publikut në institucionet e drejtësisë është objekt i një sërë rregullave me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar. Më konkretisht: 1. Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1 parashikon se: “Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike”. 2. Parimet e Bangalores për sjelljen gjyqësore, të cilat zbatohen edhe për prokurorët, parashikojnë rregullime mbi vlerat e magistratëve gjatë ushtrimit të detyrës, me qëllim krijimin e besimit të publikut. Paanësia e një magjistrati është esenciale për ushtrimin e detyrës. Ajo gjen zbatim jo vetëm në vendimmarrje, por edhe në procesin që paraprin atë. Perceptimi i mungesës së paanësisë gërryen besimin e publikut. Paanësia e një magjistrati, në kuptim të krijimit të besimit të publiku, matet me anë të testit subjektiv, i cili kryhet mbi bazën e bindjes personale në lidhje me rastin që paraqitet, si dhe testit objektiv që përfaqëson garancitë e mjaftueshme, që duhet të ofrojë magjistrati për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në lidhje me çështjen.

26.4. Komisioni ka hetuar në lidhje me faktin nëse subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit për përfitimin nga programi social i Bashkisë Fier dhe, për këtë qëllim, ka pyetur²² subjektin nëse gjatë karrierës së saj pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier ka hetuar në lidhje me kallëzime të paraqitura nga apo ndaj Bashkisë Fier dhe/ose punonjës/zyrtarë të këtij institucioni, për të cilat ka disponuar me vendim mosfillimi, pushimi, pezullimi apo dërgim për gjykim.

26.5. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: *Deri në datë 27.03.2012, nuk kam pasur dosje procedimi penale, të mosfilluara, pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim, ku si kallëzues/të kallëzuar persona ndaj të cilit zhvillohen hetime, të dëmtuar, të pandehur të ketë qenë Bashkia Fier dhe ose punonjës, zyrtarë të këtij institucioni. Më 16.07.2012, me cilësinë e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, kam trajtuar kallëzimin penal nr. {***}, të regjistruar mbi bazën e kallëzimit të disa qytetarëve të qytetit Fier. Më 30.07.2012, kam vendosur mosfillimin e këtij procedimi penal në bazë të nenit 290, pika 1, germa ç, dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale. Bashkëlidhur këtij pyetësori, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës vërtetimin nr. {***} prot., datë 11.11.2020, të lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, nëpërmjet të cilit konfirmohet deklarimi i saj.*

26.6. Në vijim të hetimit administrativ, Komisioni, për shkak të evidentimit të elementit “kohë e afërt” të kallëzimit të datës 16.07.2012 me kohën e përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese, të disbursuar më datë 30.03.2012, vlerësoi të administronte në cilësinë e provës, fashikullin e procedimit penal nr. {***}/2012, që lidhej me këtë kallëzim, të gjendur në dosjen e subjektit të rivlerësimit B. C.²³. Nga verifikimi i akteve në fashikull, ka rezultuar se, në datën 16.07.2012, mbi bazën e kallëzimit të disa qytetarëve të Bashkisë Fier, është regjistruar kallëzimi penal nr. {***}, datë 16.07.2012. Në këtë kallëzim, ndër të tjera, qytetarët referojnë se kanë paraqitur kërkesa për t’u trajtuar me banesa sociale dhe kanë pretenduar se, nga ana e Këshillit Bashkiak Fier, në datën 09.07.2012, është shkelur ligji, duke u dhënë banesa personave të cilët nuk i plotësonin kushtet për t’u trajtuar me banesë sociale. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 30.07.2012, ka vendosur: *Mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se: [...] Fakti, përveç që nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, është rrjedhojë e një votimi të fshehtë kolegjal dhe objekt i një procedure ankimi administrativ e cila edhe është ndjekur në rastin konkret. Ky vendim është ankimuar nga kallëzuesit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila, me vendimin e datës 06.02.2013, ka vendosur pranimin e kërkesës për prishjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal, duke urdhëruar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për kryerjen e hetimeve*²⁴.

²² Pyetësorit nr.3, pyetja 1/a.

²³ Sipas vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues të Komisionit, datë 27.04.2021.

²⁴ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. {***}, datë 06.02.2013, vendosi prishjen e vendimit datë 30.07.2012 “Për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. {***}, datë 16.07.2012”, duke urdhëruar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në lidhje me verifikimin e këtij kallëzimi. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ka bërë regjistrimin e procedimit penal, nëpërmjet vendimit “Për bashkimin e procedimeve” të datës 26.03.2013, ia ka bashkëlidhur këtë kallëzim procedimit penal {***}, regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal nr. {***} më datë 31.10.2012. Nga kryerja e veprimeve hetimore, është konkluduar për dërgimin për gjykim të disa prej punonjësve të Bashkisë Fier. Me vendimin nr. {***}, datë 28.05.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendosi deklarimin të pafajshëm të të gjithë

26.7. Në lidhje me situatën faktike të parashtruar më sipër, trupi gjykues vlerëson se, për të analizuar faktin nëse subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, nëpërmjet ushtrimit të tagrave ligjorë në lidhje me trajtimin e kallëzimit penal nr. {***}/2012, kundër disa zyrtarëve të Bashkisë Fier, vlerësimi duhet bërë bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, të cilat përcaktojnë kushtet dhe procedurat për deklarimin dhe shmangien e konfliktit të interesit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe rastet e heqjes dorë.

26.8. Në nenin 3, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 9367/2005, parashikohet se “konflikt i interesi” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike [...]. Në pikën 4 të të njëjtit nen parashikohen llojet e ndryshme të shfaqjes së “konfliktit të interesit” dhe, sipas germës “b”, “konflikt në dukje i interesi” është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë. Në nenin 13 të po këtij ligji, parashikohet se: *Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas këtij kreu, bëhen vetëm për ato veprime, që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe të legjislacionit që rregullon procesin e hetimit parlamentar.* Ndërkohë, Kodi i Procedurës Penale, në nenin 17, përcakton se: *Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete [...] kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.*

26.9. Referuar përkufizimeve të mësipërme, në lidhje me evidentimin e konfliktit të interesit, është e rëndësishme forma e shfaqjes së konfliktit, i cili mund të paraqitet në formën e konfliktit faktik, në dukje, të mundshëm, rast pas rasti apo të vazhdueshëm të interesit. Në rastin konkret, referuar fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vlerëson se ndodhemi para konfliktit rast pas rasti të interesit, i cili lidhet me vendimmarrjen konkrete të subjektit të rivlerësimit për trajtimin e një kallëzimit penal kundër punonjësve të Bashkisë Fier. Në lidhje me evidentimin e konfliktit rast pas rasti të interesit, janë të rëndësishme dy çështje kryesore: a) duhet të ekzistojë shfaqja e një konflikti interesi në formën e konfliktit faktik, në dukje apo të mundshëm; dhe b) ky konflikt të jetë i lidhur me një apo disa vendimmarrje të veçanta, pra, të jetë i lidhur me vendimmarrjeje konkrete dhe rolin e zyrtarit në këtë vendimmarrje. Në çdo rast, konflikti rast për rast i interesit, sipas këtyre parashikimeve ligjore, duhet kuptuar si një papajtueshmëri momentale ndërmjet detyrës publike dhe interesit

*të proceduarve për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, duke deklaruar fajtores vetëm shtetasen M. K. për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i dokumenteve”. Ky vendim i ankimuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 14.09.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë.*

privat të zyrtarit lidhur me një vendimmarrje të caktuar, e cila të jetë e ndikuar nga interesi i tij privat, i lidhur me këtë vendimmarrje.

26.10. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vëren se problematika në këtë rast lidhet me veprimtarinë procedurale të subjektit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, për trajtimin e kallëzimit penal nr. {***}/2012, kundër disa zyrtarëve të Bashkisë Fier dhe vendimin e tij për mosfillimin e procedimit penal, datë 30.07.2012. Nga rrethanat faktike të konstatuara, provohet se subjekti është trajtuar nga Bashkia Fier me kredi lehtësuese përpara vendimmarrjes për mosfillim të procedimit penal nr. {***}/2012. Nga aktet e administruara, deklaratimet dhe shpjegimet e subjektit në kuadër të procesit të rivlerësimit në Komision, nuk provohet që nga data 28.02.2011²⁵ deri më datë 30.03.2012, dita e disbursimit të kredisë, subjekti i rivlerësimit të ketë hetuar ndonjë çështje që lidhet me Bashkinë Fier, apo të ishte përfshirë në ndonjë proces administrativ pranë kësaj bashkie në kohën e dhënies së vendimit për mosfillimin e procedimit penal të datës 30.07.2012. Pas kësaj periudhe, kur kredia ishte përfituar dhe disbursuar, nuk rezulton të ketë ekzistuar një marrëdhënie ndërmjet subjektit, bashkisë apo ndonjë prej zyrtarëve të saj, e tillë që të cilësohej si marrëdhënie interesi e çfarëdolloj forme, nga ato të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9367/2005, që do ta vendoste atë në gjendjen e konfliktit të interesit përkundrejt detyrimit për të hequr dorë nga çështja, në lidhje me kallëzimin penal nr. {***}/2012.

26.11. Sa i takon konceptit “kohë e afërt”, të përdorur nga Komisioni në vendim, trupi gjykues vëren se ky element mund të cilësohej si përcaktues nëse trajtimi i kallëzimit penal do të kishte ndodhur gjatë kohës që procedura administrative pranë Bashkisë Fier nuk kishte përfunduar ende. Ndërkohë që, në rastin në shqyrtim, koha mund të cilësohet “e afërt” në raport me datën e disbursimit të kredisë, megjithatë nuk mund të cilësohet e tillë në raport me kohën e aplikimit pranë Bashkisë Fier dhe trajtimit të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për strehim, sipas ligjit nr. 9232/2004.

26.12. Po ashtu, referuar të dhënave nga dosja e procedimit penal, trupit gjykues i rezulton se kallëzimi penal nr. {***}, datë 16.07.2012, është bërë kundrejt anëtarëve të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Fier, në lidhje me vendimin nr. {***}, datë 09.07.2012, për shpërndarjen e 96 banesave sociale, në të cilin do të përcaktohej lista e familjeve që do të përfitonin nëpërmjet programit social të strehimit për banesa sociale me qira, sipas nenit 3, pika 1²⁶ e ligjit nr. 9232/2004, ndërkohë që subjekti dhe familja e saj rezulton të kenë përfituar trajtim sipas

²⁵ Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 06.04.2021, të Bashkisë Fier, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për t’u trajtuar me strehim sipas ligjit nr. 9232.2004, më datë 12.02.2011, protokolluar me nr. {***} prot., datë 28.02.2011.

²⁶ Neni 3, pika 1 e ligjit nr. 9232/2004: “Programet sociale të strehimit klasifikohen si më poshtë: 1. Programe të banesave sociale me qira, në të cilat përfshihen: a) banesat, që ndërtohen apo blihen nga tregu i lirë, nga njësitë e qeverisjes vendore ose persona juridikë privatë, të cilat jepen me kontratë qiraje sociale; b) banesat ekzistuese, në pronësi të personave fizikë ose juridikë, të cilat janë klasifikuar nga organet e qeverisjes vendore apo nga persona juridikë privatë si banesa sociale, që mund të jepen me qira për familjet që përfitojnë bonus strehimi; c) objektet e dala jashtë funksionit, si rezultat i mbylljes së një veprimtarie, të cilat kanë kaluar në pronësi të njërive të qeverisjes vendoreve dhe janë miratuar për t’u kaluar në fond banesash sociale me qira, në përputhje me planin e përgjithshëm vendor”.

programit për banesa me kosto të ulët sipas nenit 3, pika 2, si dhe nenit 19, pika 2 e të njëjtit ligj²⁷.

26.13. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur prishjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal, në lidhje me kallëzimin penal nr. {***}, datë 16.07.2012, duke urdhëruar organin e prokurorisë që të kryejë veprime hetimore në lidhje me verifikimin e tij, nga ku është konkluduar me dërgimin në gjykatë të disa personave, punonjës zyrtarë të Bashkisë Fier, fakt që tregon se vendimmarrja e subjektit dhe roli i saj në trajtimin e kësaj çështjeje nuk kanë qenë përcaktues dhe nuk kanë pasur ndikim në mënyrën se si ka vijuar dhe përfunduar ajo. Po ashtu, rezulton se, në përfundim të gjykimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurve, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, vendim i cili ka marrë formë të prerë, duke u lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mosheqja dorë e subjektit të rivlerësimit nga trajtimi i kësaj çështjeje nuk rezulton të jetë bërë në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Gjithashtu, kjo situatë faktike nuk mund të konsiderohen as si një shkak i rëndësishëm njëanshmërie, që në kuptim të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale duhet të sillte detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të hequr dorë nga çështja. Bazuar në këtë analizë, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit kjo rrethanë duhet konsideruar si një nga shkaqet për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra ndaj subjektit, sipas nenit 61 pika 5 e ligjit nr. 84/2016, gjendet i pambështetur në fakte e në ligj.

27. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kundërshton si të padrejtë dhe të pabazuar në fakte dhe në ligj konkluzionin e Komisionit se subjekti gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut, sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

27.1. Në analizë të këtij qëndrimi, sikurse është arsyetuar më lart, trupi gjykues çmon se problematikat e konstatuara në lidhje me çështjet konkrete dhe gjetjet e Komisionit nuk evidentojnë elemente të atilla që të ngrihen në nivelin e një sjelljeje të subjektit që cenon besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Faktet dhe rrethanat mbi të cilat Komisioni ka mbështetur konkluzionin e tij, nuk janë të atilla që të justifikojnë aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

27.2. Përveç sa më sipër, trupi gjykues mban në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij se analiza e të dhënave që rezultojnë vetëm nga një prej kritereve të rivlerësimit, përveç rasteve specifike, nuk mund të shërbejë në funksion të analizimit të përgjithshëm të tri kritereve, sipas nenit 2, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili kërkon që të

²⁷ Neni 19, i ligjit 9232/2004 “1. Përzgjidhet për t’u trajtuar me banesë me kosto të ulët, familja me të ardhurat maksimale mujore jo më të larta se 120 për qind e të ardhurave mesatare, të përcaktuara për prefekturën. 2. Kur banesa me kosto të ulët sigurohet përmes blerjes nga tregu, nëpërmjet një kredie hipotekore nga bankat e nivelit të dytë, me interesa të lehtësuara nga shteti, niveli maksimal i të ardhurave llogaritet nga ministria që mbulon fushën e strehimit, bazuar në vlerat mesatare të shitblerjes së banesave në treg për çdo qytet, normat e strehimit, kushtet e kreditimit nga bankat e nivelit të dytë dhe treguesin e aftësisë paguese jo më shumë se 30 për qind”.

vlerësohen në harmoni të dhënat që burojnë nga vlerësimi i tri kritereve të rivlerësimit, për të konkluduar eventualisht për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë.

27.3. Bazuar në sa më sipër, në kushtet kur nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë përdorur funksionin e prokurorit për përfitime të padrejta, dhe as nuk konstatohen sjellje që minojnë integritetin dhe autoritetin e institucioneve të drejtësisë në mënyrë të perceptueshme dhe të konsiderueshme, trupi gjykues vlerëson se nuk mund të arrihet në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, as në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

28. Trupi gjykues mori në shqyrtim e vlerësim shkaku tjetër të ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për pamjaftueshmërinë financiare, në shumën (-) 904.448 lekë, në vitin 2017, për përballimin e shpenzimeve të arsimit të djalit të saj E. Z..

28.1. Komisioni, në konkluzionet e tij, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit rezultoi me një pamjaftueshmëri financiare, në shumën (-) 904.448 lekë, në vitin 2017, për të përballuar me burime të ligjshme shpenzimet e arsimit të djalit të saj, të cilat u konsideruan se e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

28.2. Këtë përfundim, Komisioni e ka bazuar në analizën e kryer në lidhje me shpenzimet për arsim për djalin e subjektit të rivlerësimit, deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2017, sipas vlerësimit të secilës së ardhur të deklaruar si burim për mbulimin e shpenzimeve për arsimimin e personit të lidhur dhe konkretisht:

(i) Në lidhje me të ardhurat e personit tjetër të lidhur, z. E. Z., Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk i ka deklaruar të ardhurat, në shumën 2.000 euro, në DIPP-në e vitit 2016 dhe as në atë *vetting*. Subjektit iu dha mundësia të paraqiste dokumentacionin në formën e kërkuar ligjore, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nuk arriti të provonte se të ardhurat e përfituara nga i biri gjatë vitit 2016 janë të ardhura të ligjshme.

(ii) Në lidhje me dhurimet nga z. L. Z., Komisioni ka evidentuar se ky i fundit, gjatë viteve 2014-2017, ka qenë i punësuar me të ardhura totale në shumën 3.206.722 lekë, dhe se shuma e dhënë nipit të tij, z. E. Z., është në masën 8,3% e totalit të të ardhurave, duke rezultuar me mundësi për dhënien e shumës 2.000 euro.

(iii) Në lidhje me dhurimet e kryera nga kunata e saj, znj. P. K., për qëllime arsimimi për nipin, si dhe disa dhurime të tjera në shuma të vogla ndër vite, Komisioni ka vlerësuar se deklarata noteriale në lidhje me justifikimin e dhurimeve/huasë, lëshuar nga znj. P. K., përfaqëson vetëm vullnetin e saj në lidhje me to, por nuk provon nëse ajo dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të ligjshme për të kryer dhurimet/huanë e dhënë. Në këtë kontekst, këto dhurime/hua nuk mund të konsiderohen në analizën e Komisionit, përderisa subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e krijimit të tyre, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

28.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi në ankim konkluzionin e Komisionit për pamjaftueshmëri, në shumën (-) 904.448 lekë, duke pretenduar se: (i) me këtë pamjaftueshmëri

financiare është njohur për herë të parë në arsyetimin e vendimit; (ii) Komisioni ka bërë një interpretim të gabuar të provave e fakteve në lidhje me të ardhurat prej 2.000 eurosh të personit të lidhur si të ardhurat nga puna pasi, megjithëse ka vlerësuar se këto të ardhura nuk janë të ligjshme, i ka përfshirë ato në analizën e vitit 2016, por jo në atë të vitit 2017; (iii) Komisioni ka kryer analizë financiare për sa u përket shpenzimeve të kryera pas vitit 2016 dhe pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, ndërkohë që nuk ka paraqitur asnjë arsye që e ka bërë të nevojshme kryerjen e analizës për elemente që kronologjikisht i përkasin periudhës pas janarit 2017, në kundërshtim me qëndrimin tashmë të konsoliduar të Kolegjit, në çështje të mëparshme; (iv) konkluzioni i Komisionit mbi formën e paraqitjes së dokumenteve, në lidhje me të ardhurat nga znj. P. K., është i gabuar, për sa kohë që bëhet fjalë për deklarata tatimore të personave që jetojnë e punojnë në Kanada, të cilat janë skanuar nga origjinali dhe janë përkthyer nga përkthyesi zyrtar, si dhe janë noterizuar. Shuma e dhënë prej ish-kunatës së saj, konfirmohet edhe nga deklarata noteriale e kësaj të fundit, e cila është në origjinal, e legalizuar dhe me vulë *apostille*.

28.4. Në lidhje me sa më sipër, trupi gjykues konstaton se konkluzioni i Komisionit në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare, në vitin 2017, në shumën (-) 904.448 lekë, ka rezultuar i tillë, duke iu referuar jo vetëm shpenzimeve për arsimim, por si rezultat i përlllogaritjes së të gjithë shpenzimeve dhe të ardhurave të subjektit dhe personave të lidhur përgjatë gjithë vitit 2017. Megjithëse Komisioni shprehet për pamjaftueshmëri për shpenzimet për arsimim, ky konstatim është rezultat i përlllogaritjes së të gjitha shpenzimeve përgjatë vitit 2017, duke i atribuar subjektit mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në tejkalim të periudhës së rivlerësimit. Konkluzioni përfundimtar për kriterin e vlerësimit pasuror, bazuar në pamjaftueshmërinë për “pagesën e studimeve për të birin”, kryer në vitin 2017, është i paarsyetuar dhe rezultat i vlerësimi financiar të mangët nga ana e Komisionit, pasi nuk është arsyetuar mbi nevojën për shtrirjen e analizës financiare përtej vitit 2016. Bazuar në kuadrin ligjor që normon procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, subjektet e rivlerësimit mbajnë përgjegjësi për saktësinë, vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve dhe gjendjes së pasurisë deri në dorëzimin e deklaratës *vetting*. Kontrolli i të ardhurave dhe shpenzimeve, të deklaruara në deklaratat e interesave privatë për vitet 2017 dhe 2018, kryhet nga ILDKPKI-ja. Analiza e shpenzimeve të kryera pas dorëzimit të deklaratës *vetting* merr rëndësi për procesin e rivlerësimit vetëm në rrethana specifike. Në rastin konkret, nga analiza e akteve në fashikull, si dhe referuar përmbajtjes së vendimit, nuk rezulton që Komisioni të ketë arsyetuar mbi rrethana që justifikojnë analizën financiare për periudhën pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, për të ardhura dhe shpenzime që kronologjikisht i përkasin periudhës pas janarit të vitit 2017, siç ndër të tjera janë shpenzimet për shkollimin jashtë shtetit të personit të lidhur. Në arsyetimin e Komisionit nuk jepet shpjegim se përse konkluzioni përfundimtar për vlerësimin e kriterit të pasurisë bazohet në analizën financiare të vitit 2017.

29. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se shtrirja e analizës financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të edhe për vitin 2017 nuk justifikohet nga dyshime të arsyeshme në lidhje me krijimin e pasurive me burime të pajustificuara. Shtrirja e analizës financiare të Komisionit vetëm në kontroll të shpenzimeve të kryera gjatë këtij viti tejkalon qëllimin dhe frymën e legjislacionit që rregullon procesin e rivlerësimit kalimtar, të pranuar edhe nga jurisprudenca e Kolegjit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit

lidhur me këtë analizë financiare, nuk mund të shërbejë si bazë për dhënien ndaj subjektit të rivlerësimit të masës disiplinore të shkarkimit.

30. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe, në kushtet kur ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës dhe nivel kualifikues për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, vendimi i Komisionit duhet ndryshuar, duke u vendosur konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Ndryshimin e vendimit nr. 401, datë 16.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Zifla.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 11.11.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes nr. 52/2021 (JR), jam kundër vendimit nr. 55, datë 11.11.2024, me të cilin shumica e trupit gjykues vendosi *ndryshimin e vendimit nr. 401, datë 16.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Zifla.*
2. Në analizë të të gjitha akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve të dhëna nga subjekti në Komision, si dhe pretendimeve të ngritura në Kolegj, bazuar në ligjin e zbatueshëm në këtë proces, në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, nuk rezulton e besueshme lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe me veprimet e ndërmarra prej saj, dukshëm ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

I. Për pasurinë apartament banimi, ndodhur në Tiranë, në vlerën 11.210.000 lekë

3. *Lidhur me pagesën e kaparit në vlerën 1.500.000 lekë, më datë 21.12.2011, nga aktet, rezulton se në datën 21.12.2011, është lidhur kontrata e kaparit nr. {***} rep., nr. {***} kol., ndërmjet znj. Alketa Zifla, në cilësinë e dhënëses së kaparit, dhe z. H. Ll., babait të subjektit, në cilësinë e marrësit të tij, për të siguruar realizimin e detyrimit të marrë përsipër prej tyre, që ishte nënshkrimi i kontratës së shitblerjes për blerjen e këtij apartamenti. Sipas kësaj kontrate, palët do të siguronin përmbushjen e detyrimit për likuidimin e çmimit të shitblerjes së pasurisë objekt vlerësimi, në shumën 5.000.000 lekë. Në këtë kontratë, subjekti i rivlerësimit deklaroi se i ka dhënë babait të saj kaparin prej 1.500.000 lekësh, ndërsa shuma prej 3.500.000 lekësh do t'i paguhet pas përfitimit të kredisë bankare. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011 ndryshimin e interesave sipas kontratës së kaparit, për të përcaktuar burimin, vlerën e paguar dhe detyrimin e mbetur me përshkrimet përkatëse, si detyrim ligjor i saj për deklaram të saktë, në përputhje me ligjin. Prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë lëshuar një deklaratë noteriale në të cilën deklarojnë se pavarësisht lidhjes së kontratës së kaparit, datë 21.12.2011, realisht nuk kanë marrë nga vajza e tyre vlerën 1.500.000 lekë, por e kanë bërë këtë deklaram vetëm për ta ndihmuar atë për blerjen e apartamentit.*
4. Në vijim, në datën 09.03.2012, është lidhur kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., ndërmjet prindërve të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e shitësve, dhe vetë subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e blerëses. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, prindërit i kanë kaluar subjektit të drejtën e pronësisë mbi pasurinë “apartament banimi”, kundrejt çmimit prej 11.210.000 lekësh, i cili rezultoi të jetë likuiduar jashtë zyrës noteriale.
5. Subjekti, e pyetur nga ILDKPKI-ja në datën 29.03.2016, për të sqaruar mbi mospërputhjen e çmimit të deklaruar për këtë pasuri në deklaratën e interesave periodikë vjetorë 2012, në shumën 3.452.000 lekë, dhe çmimit të kontraktuar në kontratën e shitjes në shumën 11.210.000 lekë, si dhe mbi mënyrën e pagesës së diferencës 7.710.000 lekë, ka sqaruar, ndër të tjera, se: *meqenëse ky apartament është rivlerësuar, është vendosur në kontratën e shitblerjes çmimi 11.210.000 lekë, apartament i ngarkuar me barrë hipotekore, në favor të kredisë së marrë në datë 03.04.2012, në shumën 3.452.000 lekë. Në aneksin e elementeve specifike të kredisë, është përcaktuar se shuma prej 3.500.000 lekësh do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të*

çmimit të blerjes së apartamentit dhe shuma e disbursuar do të transferohet nga llogaria e kredisë në favor të shitësit, prindërve të subjektit të rivlerësimit, me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së. Referuar lëvizjeve të llogarive bankare pranë BKT-së, ka rezultuar se shuma prej 3.500.000 lekësh, e cila është disbursuar në datën 30.3.2012, si kredi në favor të subjektit të rivlerësimit, është transferuar në datën 3.4.2012, në vlerën 3.452.000 lekë, në llogari të prindërve të subjektit si palë shitëse. Kjo shumë është investuar po në BKT nga prindërit e subjektit gjatë periudhës 2012 – 2016, në depozitë me afat (bono thesari) dhe të gjithë interesat e përfutur, në vlerën 665.000 lekë për këtë periudhë, si rrjedhojë e këtyre investimeve, janë transferuar nga llogaria e prindërve në llogari të kredisë së subjektit Alketa Zifla, të cilat kanë shërbyer për të paguar këstet e kredisë së subjektit për blerjen e apartamentit. Është pyetur subjekti në Komision lidhur me shlyerjen e kësteve të kredisë, por ka pretenduar se është ndihmuar nga prindërit e saj, gjë të cilën nuk e kishte deklaruar në deklaratat periodike përkatëse vjetore për këto të ardhura të përfutuara nga prindërit e saj.

6. Për sa evidentuar më sipër, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë konform ligjit pasurinë e saj, mënyrën e fitimit, vlerën e pasurisë, duke qenë kontradiktore në shpjegimet e saj, si mospërputhja në lidhje me deklarimin e çmimit për blerjen e kësaj pasurie apartament banimi në deklaratën e interesave periodikë vjetorë të vitit 2012 në raport me atë në deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu dhe ndërmarrja prej saj e një sërë veprimesh fiktive për përfitimin e kësaj pasurie, qëllimi i të cilave nuk ka qenë ai i parashikuar në kontratat respektive, të nënshkruara nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe nuk ka deklaruar saktë në lidhje me vlerat e përfutuara në deklaratat periodike vjetore.

Lidhja e një kontrate kapari, ku mungon vullneti real i palëve, pa pasur realisht qëllimin për ta paguar atë, si dhe nënshkrimi i një kontrate shitjeje, kundrejt një çmimi disa herë më të lartë se ai i dakordësuar në kontratën e kaparit, i papaguar ndonjëherë sipas subjektit të rivlerësimit, perceptohet negativisht si në aspektin ligjor, ashtu edhe në atë etik dhe profesional për një prokurore.

7. Qëndrime të tilla të subjektit të rivlerësimit, si: lidhja e kontratës së kaparit me akt noterial në vlerën prej 1.500.000 lekësh, e pretenduar nga subjekti e papaguar asnjëherë, pavarësisht që aneksi i kontratës së kredisë parashikonte se kjo kredi do të përdorej për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit, kalimi i vlerës së kredisë te prindërit në cilësinë e shitësve, pastaj në bono thesari nga këta të fundit, dhe interesat e përfutur kalojnë për shlyerjen e kësteve të kredisë të përfutur nga subjekti, për mua si gjyqtare në pakicë, janë veprime sjelljeje të subjektit të rivlerësimit në formë manovrash, jo të bazuara në provat shkresore të administruara në dosje, si dhe tregojnë një mekanizëm ku nëpërmjet prindërve të saj, tenton të mbulojë çmimin real të apartamentit dhe shtesës në qytetin e Tiranës, mënyrën e likuidimit, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut të funksionarët e sistemit të drejtësisë, në drejtim të perceptimit të publikut mbi integritetin dhe seriozitetin me të cilin funksionarët e sistemit të drejtësisë respektojnë dhe zbatojnë ligjin në kryerjen e veprimeve juridike.
8. *Lidhur me përfitimin e kredisë nga Bashkia Fier nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare, me anë të kontratës bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.3.2012, në shumën 3.452.000 lekë, nga analiza e kuadrit ligjor të zbatueshëm në kohën e përfitimit të kredisë, rezulton se kredia me kushte lehtësuese rregullohej nga ligji nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet*

sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar me ligjin nr. 22/2018). Ky ligj synonte krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm për familjet, *brenda juridiksionit të bashkisë përkatëse të Republikës së Shqipërisë*. Në nenin 18 të këtij ligji, përcaktoheshin kriteret për përfitimin e kredisë lehtësuese, për: a) *familjet që në çastin e paraqitjes së kërkesës pranë zyrës përkatëse të bashkisë, nuk kanë në pronësi një banesë*, ndërsa në nenin 5, “Kriteret e përzgjedhjes se përfituesve”, përcaktohej se trajtohen me përparësi: a) *familjet, të cilat vërtetojnë se nuk kanë përfituar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore"*.

9. Veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, duken qartë që kanë ardhur në kundërshtim të hapur me këto dispozita ligjore, fakt i vërtetuar nëpërmjet: (i) transferimit të regjistrimit në zyrën e gjendjes civile, Bashkia Fier; (ii) angazhimin e bashkëshortit të subjektit në një marrëdhënie shitblerjeje (me rezervë e pronës) sipas kontratës së shitjes me këste me nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 25.05.2006, të një apartamenti në Tepelenë, bashkë me të atin, sipas ligjit nr. 9416, datë 20.05.2005, “Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banësive”; (iii) përdorimi i kredisë për blerjen e një apartamenti në Tiranë, duke qenë me banim dhe duke ushtruar funksionin e prokurores në qytetin e Fierit; (iv) çmimi i apartamentit i paguar plotësisht nga kjo kredi, në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, vlerësuar në harmoni me sa arsyetuar më sipër, përmban elemente fiktiviteti, në kushtet e hartimit dhe nënshkrimit të një sërë aktesh juridike që nuk përcaktojnë vullnetin real të palëve, por janë kryer vetëm në funksion të plotësimit të kriterit formal të kushteve të përfitimit të kredisë, me qëllim blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi.

II. Lidhur me konfliktin e interesit

10. Bindjen që subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredi me kushte lehtësuese, në kundërshtim me parashikimet ligjore, ma përforcojnë edhe faktet e rrethanat e rezultuara gjatë hetimit administrativ në Komision.

10.1. Subjekti i rivlerësimit, siç u shpreha më lart, është trajtuar nga Bashkia Fier me kredi lehtësuese, kredi e cila është disbursuar më datë 30.03.2012.

10.2. Mbi bazën e kallëzimit të disa qytetarëve të Bashkisë Fier, është regjistruar kallëzimi penal nr. {***}, datë 16.07.2012, të cilët kishin paraqitur kërkesa për t’u trajtuar me banesa sociale dhe kanë pretenduar se, nga ana e Këshillit Bashkiak Fier, në datën 09.07.2012, është shkelur ligji duke u dhënë banesa personave të cilët nuk i plotësonin kushtet, për t’u trajtuar me banesë sociale. Subjekti i rivlerësimit, më datë 30.07.2012, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

10.3. Vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të ketë kaluar kontrollin gjyqësor të ligjshmërisë, në kushtet kur pas ankimit të kallëzuesve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e datës 06.02.2013, ka vendosur prishjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore.

11. Në kushtet kur kallëzimi penal i muajit korrik 2012, i adresohet paligjshmërisë në ushtrimin e detyrës të funksionarëve të Bashkisë Fier, ku në muajin mars 2012 kishin miratuar kredinë me kushte lehtësuese ndaj subjektit të rivlerësimit, subjekti duhej të hiqte dorë nga hetimi i këtij kallëzimi, në kuptim të nenit 17, pika “ë” e Kodit të Procedurës Penale, “kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”. Mosheqja dorë në këtë rast, reflekton negativisht mbi perceptimin që ka publiku ndaj prokurorit që merr vendim mosfillimi ndaj një kallëzimi penal, në të cilin janë përfshirë funksionarët publikë, të cilët kanë miratuar kundrejt saj përfitimin e kësaj kredie, për më tepër në mungesë të plotësimit të kriterëve ligjore.
12. Në përfundim të sa më sipër, rrethanat e tilla si: (i) veprimet fiktive (simuluar), nëpërmjet nënshkrimit të kontratave për blerjen e apartamentit; (ii) përfitimi i kredisë lehtësuese në kundërshtim me ligjin; (iii) marrja pjesë në hetim dhe mosheqja dorë nga procedimi penal ndaj funksionarëve të cilët kishin miratuar kredinë në kushte lehtësuese për subjektin e rivlerësimit, procedim penal i cili ishte iniciuar nga kallëzimi penal i qytetarëve fierakë që nuk kishin përfituar kredi të kësaj natyre; (iv) vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit si prokurorë për mosfillim të procedimit penal; (v) mosdeklarimi në deklaratat periodike vjetore të veprimeve juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit, si: kontratën e kaparit, vlerën e kësaj kontrate, të ardhurat e përfituara nga prindërit, siç pretendon subjekti, në shlyerjen e kësteve të kredisë etj., në vlerësimin tim, tregojnë sjellje të subjektit të rivlerësimit që vijnë në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Aneksin e saj, përkatësisht nenin D: [...] *Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën [...].*
13. Me veprimet e saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Bazuar në sa analizuar më sipër, çmoj se vendimi i shumicës nuk është i thelluar në analizë ligjore, për të krijuar një panoramë më reale të situatës, si dhe në mungesë të një analize financiare të mirëfilltë, në kuadër të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, lidhur me subjektin dhe personat e tjerë të lidhur. Në këto kushte, e vlerësoj vendimin e shumicës të pabazuar në ligj dhe vendimin e Komisionit e konsideroj të drejtë dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi